AUTORËT

Behxhet Mustafa, Avni Hajdari, Shpresa Sojeva Mustafa

LIBRI I MËSIMDHËNËSIT/ES

# BIOLOGJIA 6

Për klasën e gjashtë të arsimit të mesëm të ulët

## PËRMBAJTJA


Temat mësimore të shpërndara gjatë muajve (Planifikimi vjetor) .......... 7

**PERIUDHA I**

Planifikimi dymujor: Shtator – Tetor .......... 8
Planifikimi dymujor: Nëntor – Dhjetor .......... 14

**PERIUDHA II**

Planifikimi tremujor: Janar – Shkurt-Mars .......... 19

**PERIUDHA III**

Planifikimi tremujor: Prill-Maj-Qershor .......... 23

**PLANET PËR NJËSITË MËSIMORE** .......... 26

**PJESA E PARË**

**BIODIVERSITETI**

Biologjia-shkenca për jetën .......... 27
Qelizat japin indet, organet, organizmin .......... 29
Karakteristikat e qenieve të gjalla .......... 31
Sistematika-klasifikimi i organizmave .......... 33
Mbretëritë e botës së gjallë .......... 35
Biodiversiteti- vlera më e lartë e natyrës .......... 37
Biodiversiteti i Kosovës .......... 39

**PJESA E DYTË**

**QENIET E GJALLA DHE MJEDISI JETËSOR**

Organizmi i qenieve të gjalla .......... 42
Biosfera- shtresa e tokës ku zhvillohet jeta .......... 44
Funksionimi i ekosistemit .......... 46
Qarkullimi i energjisë në ekosistem .......... 48
Ekologjia e popullatave .......... 50
Dinamika e popullatës - ndryshimet afatshkurtra dhe afatgjata të popullatës .......... 52
Ndërveprimet mes qenieve të gjalla .......... 54
Sjelljet e shtazëve .......... 56
Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve .......... 58
Struktura trupore, përcaktuese e sjelljes te shtazët .......... 60

Sjelljet ciklike ....................................................................62
Organizimi i biocenozave dhe qëndrueshmëria e ekosistemeve ....................................................................63
Suksesionet (njëpasnjëshmëritë) ekologjike ....................................................................65
Klasifikimi e ekosistemeve ....................................................................67
Biomat tokësore ....................................................................69
Pyjet e zonave me klimë të nxehtë ....................................................................70
Biomat barishtore ....................................................................72
Biomat me kushte të pavolitshme për jetesë ....................................................................73
Ekosistemet tokësore të kultivuara - antropogjene ....................................................................76
Ndikimi i njeriut në natyrë dhe mjedis jetësor ....................................................................78
Cilët janë faktorët e shkatrrimit të pyjeve .................................................................... 79
Ndotja e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij ....................................................................82
Ndryshimi i klimës-ngrohja globale (efekti serrë) ....................................................................84

**PJESA E TRETË**

**SHËNDETI, SJELLJET DHE EMOCIONET E NJERIUT**

Si ta mbajmë higjienën për një jetë të shëndetshme? ....................................................................86
Riprodhimi te njeriu dhe edukata seksuale ....................................................................88
Puberteti ....................................................................89
Seksualiteti njerëzor ....................................................................91

Test....................................................................93
Test....................................................................96

## PARATHËNIE

Libri i mësimdhënës-it/es“Biologjia 6” është hartuar në bazë të plan-programit mësimor, sipas Kurrikulës së re të aprovuar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë së Kosovës. Ky libër është përgatitur për fushën kurrikulare: Shkencate natyrës, lëndën: Biologji 6,Shkalla e kurrikulës:III.

Ky libër është pjesë e kompletit të librit të mësimit “Biologjia 6” dhe do t’u shërbejë mësimdhënësve/eve si mjet ndihmës për të zbërthyer përmbajtjen e lëndës, e cila është organizuar sipas konceptit, temave, njësive mësimore dhe rezultateve të të nxënit të lëndës (RNL).

Në këtë libër keni modelet për planin vjetor, planet dymujore, ato tremujore, si dhe është dhënë një model i orës së mësimit për secilën njësi mësimore (zhvillim), i cili mund të përdoret për realizimin e orës mësimore. Mirëpo, kjo nuk do të thotë që mësimdhënësit/et nuk mund të përzgjedhin metoda dhe planifikime të tjera për realizimin e njësive mësimore. Ata mund t’i përshtatin metodologjitë, strategjitë dhe teknikat e mësimdhënies, varësisht nga nevojat dhe kërkesat e nxënësve, me qëllim të arritjes së rezultateve të pritura të të nxënit për orë mësimore. Ky model i librit të mësimdhënës-it/es është bërë duke u konsultuar dhe me mësimdhënës të biologjisë të shkollës së mesme të ulët dhe të lartë.
Në libër gjeni dhe dy teste si shembull që ju ndihmojnë për vlerësimin e nxënësve.

Suksese në mësimdhënie dhe arritje në rezultate të të nxënit ju dëshirojnë,
Autorët.

# PLANI VJETOR

## TEMAT MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI VJETOR)

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| Shkencat e natyrës | Biologji | Shkalla **III** | **6** |

| Koncepti: Bota e gjallë | | | |
|---|---|---|---|
| **PERIUDHA (I)** | | **PERIUDHA (II)** | **PERIUDHA (III)** |
| **Shtator- Tetor** | **Nëntor- Dhjetor** | **Janar-Shkurt -Mars** | **Prill-Maj-Qershor** |
| Biodiversiteti | Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor | Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor | Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor<br><br>Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut |
| **Kontributi në rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës III, klasa e VI** | | | |
| **I**-Kompetenca e komunikimit dhe e të shprehurit – **Komunikues efektiv**<br>**1,2,3,4,6;** | | | |
| **II**-Kompetenca e të menduarit –**Mendimtar kreativ**<br>**1,6,7,8;** | | | |
| **III**-Kompetenca e të nxënit – **Nxënës i suksesshëm**<br>**1,3,4,5,6,8;** | | | |
| **IV**-Kompetenca për jetë, për punë dhe për mjedis – **Kontribues produktiv**<br>**1,3,4,7;** | | | |
| **V**-Kompetenca personale – **Individ i shëndoshë**<br>**3,7,9;** | | | |
| **VI**-Kompetenca qytetare – **Qytetar i përgjegjshëm**<br>**6.7;** | | | |

**Periudha e I**

| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: Shkalla **III** | Klasa: **6** |
| --- | --- | --- | --- |

**PLANI DYMUJOR: Shtator – Tetor**

**Tema-t mësimore : Biodiversiteti**

**RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen**

**I 1.**Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.
**2.**Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.
**3.**Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.
**4.**Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit.
**6.** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**II 1.**Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.
**6.**Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.

**III 1.**Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.
**3.**Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.
**5.**Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**IV 7.**Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj).

**RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.
Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

| Tema-t mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL | Njësitë Mësimore | Koha mësimore (orë) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Biodiversiteti** | Shpjegon konceptin, Biologjia – shkencë natyrore<br>Përshkruan organizimin shkallë – shkallë të sistemeve biologjike-ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individi), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemidhe biosfera. | **Biologjia – shkenca për jetën**<br><br>**Qelizat japin indet-organet-organizmin** | **17** | Mësimdhënie dhe të nxënit që nxit hulumtimin e pavarur;<br><br>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)<br><br>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale. | Gjuhë dhe komunikim<br>Ekologji dhe mjedis<br>Gjeografi<br>TIK<br>Ed.Qytetare<br>Matematikë<br>Art Figurativ<br>Histori. | Libri Biologjia 6, (B.MustafaA.Hajdari, Sh.Mustafa)Agjensioni për mbrojtjen e mjedisit të Kosovës<br>(https://www.ammk-rks.net/repository/docs/Biodiversiteti_i_Kosoves.pdf)<br>Paketa e gjelbër. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Biodiversiteti** | Krahason karakteristikat e organizmave brenda mbretërive të bimëve ose shtazëve (p.sh. krahason karakteristikat e një peshku dhe një gjitari, të një peme Gjethëmbajtëse halore dhe një peme gjethërënëse, të fiernave dhe bimëve me lule).<br><br>Identifikon rregullat themelore të emërtimit, klasifikimitdhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla.<br>Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike.<br>Përdorë çelësa të thjeshtë dikotomik për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë.<br>Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkolle, park qyteti, kënetë, lum, pyll, livadh, etj,) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit. | **Karakteristikat e organizmit**<br><br>**Sistematika-klasifikimi i organizmave** | | Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pytejeve drejtuar nxënësve Mësimëdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);<br><br>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore.<br><br>Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim(Në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit).<br><br>Mësimdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale.<br><br>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. | Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)<br><br>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte<br>Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimor.<br><br>Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës),<br>Vlerësimi i detyrave të shtëpisë. | | Video, fotografi nga interneti |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Biodiversitet** | Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët nuk kanë shtyllë rruazore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdorë këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët- arthropodat- insektet; vertebrorët- gjitarët- primatë; bimët bimët me fare- bimët me lule- bimët barishtore) | **Mbretëritë e botë së gjallë** | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Biodiersitet** | Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë llojllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peisazhit fizik që i mbështet ato.<br><br>Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe zhdukjes së disa bimëve ose shtazëve (p.sh. për shkak të gjuetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invasive, ndryshimeve dhe shkatërrimeve të habitatit). Shpjegon rëndësinë e biodiversitetit për stabilitetin e ekosistemeve natyrore dhe përfitimet e njeriut nga biodiversiteti (sigurimin e resurseve jetësore si ushqimi, barnat, lëndët e para për prodhime të ndryshme etj.). | **Biodiversiteti- vlera më e lartë e natyrës** | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Biodiversitet** | Identifikon produktet e jetës së përditshme të cilat kanë origjinë nga diversiteti i organizmave (p.sh. mëndafshi nga krimbi i mëndafshit, suplementët ushqimor, shamponët, pastaj e dhëmbëve dhe dezodorantët qëpërmbajnë polen të mbledhur nga bletët etj.). Vlerëson përfitimet që ka shoqëria njerëzore nga biodiversiteti si dhe problemet që shkaktohen nga zvogëlimi i biodiversitetit. Identifikon bimët dhe shtazëtendemike, të rrezikuara për zhdukje, që jetojnë në Kosovë.<br><br>Identifikon mënyra për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë. Analizon një çështje lokale të lidhur me biodiversitetin (p.sh. efektet e aktiviteteve të njeriut në biodiversitetin urban). Vlerëson rolin dhe ndikimin e njeriut në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit-nivel global. | **Biodiversiteti i Kosovës** | | | | | |

## NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI DYMUJOR)

| **Fusha kurrikulare:** | **Lënda:** | **Shkalla e kurrikulës:** | **Klasa:** |
|---|---|---|---|
| Shkencat e natyrës | Biologji | Shkalla **III** | **6** |

**PLANI DYMUJOR: Nëntor-Dhjetor**

**Tema-t mësimore : Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

**RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen**

**I 2.** Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

**3.** Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

**4.** Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit .

**6**. Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**II 1.** Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.

**6.** Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim

**8.** Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.

**III 1.** Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.

**3.** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet

**4.** Shfrytëzon dosjen personale për identifikimin e përparësive dhe mangësive në funksion të vetëvlerësimit të përparimit dhe përmirësimit të suksesit në fushën e caktuar.

**5.** Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**IV 7.** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj.

**RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

| Tema-t mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL | Njësitë Mësimore | Koha mësimore (orë) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Definon nocionet/termat themelore ekologjike.<br>Diskuton efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes).<br><br>Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi- karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit- tipet e organizmave tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit). | **Organizimi i qenieve të gjalla**<br><br>**Çka kuptohet me mjedis?** | **16** | Mësimdhënie dhe të nxënit që nxit hulumtimin e pavarur;<br><br>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)<br><br>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale. | Gjuhë dhe komunikim<br>Ekologji<br>Gjeografi<br>TIK<br>Ed.Qytetare.<br><br>Matematikë<br>Art Figurativ. | Libri Biologjia 6, (B.MustafaA.Hajdari, Sh.Mustafa).<br><br>Video, fotografi nga interneti. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | **Bënë dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.- Organizmi është qenie e gjallë.-** Popullata definohet si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçant Shfrytëzon organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.<br><br>Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e ekosistemit.<br><br>Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zbërthimit të lendëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit duke shpjeguar nocionet prodhuesit dhe konsumuesit. | **Biosfera dhe njësitë që e përbëjnë atë**<br><br>**Funksionimi i ekosistemit**<br><br>**Qarkullimi ciklik i materieve në ekosistem** | | Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pytejeve drejtuar nxënësve Mësimëdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);<br><br>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore<br><br>Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim(Në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit)<br><br>Mësimdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale<br><br>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve | Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)<br><br>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore<br><br>Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës), Vlerësimi i detyrave të shtëpisë. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Përshkruan shndërrimin e energjisë së dritës në energji kimike gjatë krijimit të lëndëve ushqyese në shembullin e fotosintezës duke mos u shërbyer me simbole kimike në pasqyrimin e ekuacionit të fotosintezë.<br>-Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesëve, konsumuesëve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rrjetën e ushqimit<br><br>Bënë dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.- Organizmi është qenie e gjallë.- **Popullata definohet si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar.Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë** | **Qarkullimi i energjisë në ekosistem**<br><br>**Ushtrime (vlerësim)**<br><br>**Ekologjia e popullatave** | | | | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim). | **Ndërveprimet mes qenieve të gjalla**<br><br>**Vlerësim përmbledhës** | | | | | |

**Periudha e II**

**NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI TREMUJOR)**

| Fusha kurrikulare: | Lënda: | Shkalla e kurrikulës: | Klasa: |
|---|---|---|---|
| Shkencat e natyrës | Biologji | Shkalla **III** | **6** |

**PLANI TREMUJOR: Janar- Shkurt- Mars**

**Tema-t mësimore : Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

**RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen**

**I 2**. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.

**3.** Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.

**4.** Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit .

**6.** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**II 1.** Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.

**6.** Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim

**7.** Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.

**III 1.**Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën

**3.** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet

**5.** Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

**6**. Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.

**8.** Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).

**IV 7.** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj.

| RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve: | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut. | | | | | | | |
| **Tema-t mësimore** | **Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL** | **Njësitë Mësimore** | **Koha mësimore (orë)** | **Metodologji a e mësimdhëni es** | **Metodologji a e vlerësimit** | **Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurriku** | **Burimet** |
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim). Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh. ujqit udhëtojnë në grup për të mbrojtur territorin e tyre, rrisin të vegjëlit (këlyshët) e tyre dhe gjuajnë prenë e madhe). | **Sjelljet e shtazëve**<br><br>**Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve**<br><br>**Struktura trupore përcaktuese e sjelljes së shtazëve** | **22** | Mësimdhënie dhe të nxënit që nxit hulumtimin e pavarur;<br><br>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)<br><br>Vlerësimi i punës praktike/eksperimentale. | Gjuhë dhe komunikim<br>Ekologji<br>Gjeografi<br>TIK<br>Ed.Qytetare<br><br>Matematikë<br>Art Figurativ. | Libri Biologjia 6, (B.MustafaA.Hajdari, Sh.Mustafa)<br><br>Video, fotografi nga interneti. |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm duke pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegojnë se si këto marrëdhënie mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit.<br><br>Shfrytëzon organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme. Përdorë fjalor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësia jetësore natyrore (biocenoza), marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët-kurrizorët, invertebrorët-parruazorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmi etj.<br><br>Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificial.<br><br>Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificial. | **Sjelljet ciklike**<br><br>**Organizimi i biocenozave dhe qëndrueshmëria e ekosistemeve**<br><br>**Suksesionet (njëpasnjëshmëri të) ekologjike**<br><br>**Klasifikimi i ekosistemeve**<br><br>**Biomet tokësore** | | Mësimdhënie me anë të pyetjeve (teknika e pytejeve drejtuar nxënësve Mësimëdhënie indirekte (shqyrtimi, zbulimi, zgjidhja e problemeve);<br><br>Mësimdhënie përmes projekteve, punëve kërkimore<br><br>Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim(Në grupe të vogla dhe të mëdha dhe me të gjithë nxënësit)<br><br>Mësimdhënie dhe të nxënit përmes mjeteve multimediale<br><br>Mësimdhënie që nxit të menduarit kritik, krijues dhe zgjidhjen e problemeve. | Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).<br><br>Vlerësim për ecurinë dhe produktin e punës me projekte Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore.<br><br>Vlerësimi me shkrim i cili realizohet përmes teknikave të ndryshme (testeve, kuizeve, eseve, raportet e punës), Vlerësimi i detyrave të shtëpisë. | | |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshti, livadhi, pema, këneta, përroi etj.).<br><br>Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale. | **Pyjet e zonave me klimë të nxehtë**<br><br>**Biomet barishtore**<br><br>**Biomet me kushte të papërshtatshme**<br><br>**Ekosistemet tokësore të kultivuara - antropogjene**<br><br>**Vlerësim përmbledhës** | | Mësimdhënie e drejtpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembujt) Diskutimi dhe të nxënit në bashkëpunim ( në grupe të vogla, grupe më të mëdha dhe me të gjithë nxënësit). | | | |

**Periudha e III**

**NJËSITË MËSIMORE TË SHPËRNDARA GJATË MUAJVE (PLANI TREMUJOR)**

| **Fusha kurrikulare:** Shkencat e natyrës | **Lënda:** Biologji | **Shkalla e kurrikulës:** Shkalla **III** | **Klasa:** **6** |
|---|---|---|---|
| **PLANI TREMUJOR: Prill- Maj- Qershor** | | | |
| **Tema-t mësimore : Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor, Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut** | | | |
| **RNK- Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës që synohen të arrihen** | | | |
| **I 2**. Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.<br>**3.** Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.<br>**4.** Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit .<br>**6.** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.<br>**II 1.** Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.<br>**6.** Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim<br>**7.** Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.<br>**III 1.** Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën<br>**3.** Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet<br>**5.** Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.<br>**8.** Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).<br>**IV 1.** Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.<br>**3.** Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.<br>**4**. Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet.<br>**7.** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë | | | |

klase/shkolle apo jashtë saj

**V** **3.** Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.

**7.** Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendo

**9.** Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.

**VI** **6.** Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen e cilësisë së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.

**7.** Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.

**RNF- Rezultatet e të nxënit të fushës kurrikulare të shkallës që synohen të arrihen përmes shtjellimit të temës/ve:**

Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut. Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.

| Tema-t mësimore | Rezultatet e të nxënit për tema mësimore RNL | Njësitë Mësimore | Koha mësimore (orë) | Metodologjia e mësimdhënies | Metodologjia e vlerësimit | Ndërlidhja me lëndë tjera mësimore, me çështjet ndërkurrikulare | Burimet |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ) . Ndikimi pozitiv: p.sh.Ruajtja-konservim i biodiverstetit, pyllëzimi; Ndikimi negative: p.sh. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi , ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale. • Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi , ndotja (tokë/ujë/ajër), **ngrohja globale. •** | **Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor**<br><br>**Faktorët e shkatërrimit të pyjeve**<br><br>**Ndotja e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij**<br><br>**Ndryshimi i klimës – Ngrohja globale** | 20 | Mësimdhënie dhe të nxënit që nxit hulumtimin e pavarur;<br><br>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). | Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)<br><br>Vlerësimi i punës praktike/eksper-imentale. | Gjuhë dhe komunikim Ekologji Gjeografi TIK Ed.Qytetare<br><br>Matematikë Art Figurativ. | Mësimdhënie dhe të nxënit që nxit hulumtimin e pavarur;<br><br>Mësimdhënie e drejtëpërdrejtë (shpjegim, sqarim, ushtrime praktike dhe shembuj). |

| | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut** | Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre.<br><br>Shpjegon procesin e rritjes dhe zhvillimit, proceseve riprodhuese njerëzore dhe problemet e abuzimit seksual.<br><br>• Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit.<br>• Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjate cikleve të ndryshme të jetës.<br>• Identifikon institucionet ku mund të kërkojëndihmë adekuate. | **Si ta mbajmë higjienën për një jetë të shëndetshme**<br><br>**Riprodhimi te njeriu dhe edukata seksuale**<br><br>**Puberteti**<br><br>**Seksualiteti njerzor**<br><br>**Vlerësim përmbledhës** | | | | | |

# PLANET PËR NJËSITË MËSIMORE

**Periudha e I**

**Shtator- Tetor**

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):
**Biodiversiteti**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):
*Shpjegon konceptin, Biologjia – shkencë natyrore*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

III- 3. Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.

III- 5. Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*
*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Biologjia – shkenca për jetën**

Fjalët kyçe: *Biologji, qelizë, organele qelizore, eukaryote, prokariote, bërthamë, citoplazmë, bimore, shtazore,*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Interpreton konceptin Biologji*
*Shpjegon ndërtimin e qelizës bimore dhe shtazore*
*Dallon organizmat prokariot dhe eukariot*

Kriteret e suksesit:

*Defino konceptin Biologjia shkencë natyrore*
*Krahaso qelizës bimore me atë shtazore*
*Identifiko dallimet në mes të organizmave eukariot dhe prokariot përmes fotografisë*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri "Biologjia 6", model qeliza bimore, model qeliza shtazore, veza e zier e pulës*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Art figurativ, Histori*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

**Njësinë e re mësimore mësimdhënsja e fillon me teknikën "Stuhi mendimesh" nxënësit do të shprehin mendimet e tyre lidhur me atë çfarë ata dine rreth konceptit "Biologjia shkencë natyrore".*
*Pastaj rrjedhimisht përmes pyetjeve flasin për historinë e zbulimit të qelizës, cili ishte shkencëtari që e zbuloi atë dhe në çfarë mënyre arriti të zbuloj celulat që ngjasonin me hojet e bletëve, a mund të shihen me sy të gjitha qelizat. Mësimdhënësi/ja dëgjon dhe shkruan në tabelë mendimet e nxënësve pa i pohuar apo mohuar ato, në mënyrë që nxënësit në fund të bëjnë vetëvlerësimin e njohurive paraprake.*

DRTA

*Pastaj udhëzon nxënësit që të punojnë në grupe dhe të hapin librin faqe 11 dhe të lexojnë dy prej grupeve paragrafin pare, dy prej grupeve paragrafinë e dytë, dhe dy grupet e fundit paragrafinë e tretë, pas leximit në heshtje ti komentojmë ato. Derisa nxënësit fillojnë diskutimin e drejtuar me pyetjen për çfarë po bëhet fjalë në pjesën që lexuat nga paragrafi i parë? (mësimdhënsja mbanë në duar një vezë të zier (të pulës)).*

*Ata fillojnë të diskutojnë strukturën e qelizës, tregojnë ndërtimin e qelizës, duke filluar nga membrana si mbështjellës i saj (këtu ndalon diskutimin duke u treguar mbështjellësin e vezës së zier), për të vazhduar më tej me citoplazmën (të bardhën e vezës), pastaj vazhdonë me bërthamën (të verdhen e vezës).*

*Vazhdon me nxënësit që kishin lexuar paragrafinë e dytë.*




*(modelet e qelizave)*

*Pas leximit nxënësit përmes fotografive në libër dallojnë qelizën bimore nga ajo shtazore, ndërkohë që paravetës kanë edhe modelin për të dy qelizat, aty arrijnë të krahasojnë qelizën bimore nga ajo shtazore, duke spikatur karakteristikat dalluese. Vazhdonë me paragrafinë e tretë këtu nxënësit komentojnë dallimet në mes të organizmave eukariot dhe prokariot.*

DIAGRAMI I VENIT

*Dhe në pjesën përfundimtare fton nxënësit që përmes një diagrami të venit të paraqesin dallimet në mes të qelizës bimore edhe asaj shtazore, si dhe dallimet në mes të organizmave eukariot dhe prokariot, dhe si përfundim të definojnë koncetin Biologjia shkencë natyrore.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Krijoni me mjete shtëpie një qelizë bimore dhe një qelizë shtazore*

REFLEKTIMI PËR ORË MËSIMORE

**Aktivitet shtesë:**

*- Krijojnë një model tredimensional të qelizës (një bimore dhe një shtazore). Për modelim sugjeroju materiale të tilla, si xhelatinë për citoplazmë, masë plastike ose qese për membranën qelizore dhe objekte të ndryshme të vogla, të tilla si mermer apo guralecë për bërthamën dhe organelet e tjera.*

*- Vrojtojnë me mikroskop ndërtimin e qelizës prokariotet te ujërat e ndotura, të qelizës bimore te epiderma e qepës dhe qelizës shtazore te epiderma e gojës.*

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës    Lënda: Biologji    Shkalla e kurrikulës: III    Klasa:VI | |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br>Biodiversiteti | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Përshkruan organizimin shkallë – shkallë tësistemeve biologjike- ekologjike në natyrë në nivele të ndryshme: qeliza, indi, organi, sistemi i organeve, organizmi (individi), popullata, bashkësia jetësore, ekosistemidhe biosfera.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

I-3.*Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

I 6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

III-5. *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Qelizat japin indet- organet-organizmin**

Fjalët kyçe: *Qelizë, ind, organ, sistem i organeve, organizëm, popullatë, bashkësi jetësore, ekositem.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Definon qartë konceptet qelizë, ind, organ, organizëm*
*Përshkruan radhitjen logjike të koncepteve*
*Vlerëson pranin apo mungesen e ndonjërës nga to (qelizë, ind, organ) në organizëm*

Kriteret e suksesit:

*Identifiko nga figura qelizën, indin, organin, organizmin.*
*Jep një shembull të organizimit hierarkik të një organizmi*
*Sqaro funksionimin e organizmit nëse largojmë ndonjërën nga konceptet e përmendura*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, llaptop, projektor,fotografi, fleta A4, modele organet (zemra, gjethi, veshkët)*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, TIk, Art Figurativ*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM PËR NJOHURITË PARAPRAKE

*Mësimdhënësi/ja prezanton njësinë mësimore, qelizat, indet dhe pastaj e fillon mësimin me një demonstrim të disa organeve (Gjeth, zemër, veshkë). Pas demonstrimit ai vazhdon duke u parashtruar pyetje nxënësve të cilët mund të përgjigjen me njohuritë paraprake për ndërtimin e një organi: A mund të vërehen qelizat dhe indet e një organi me sy të lirë?*

*Përgjigje: Jo të gjitha qelizat mund të vërehen me sy të lirë, shumica janë të padukshme për syrin e njeriut.*
*Mësimdhënësi/ja analizon këtë fragment: Shumë qeliza formojnë një ind, shumë inde formojnë një organ.*

## PËRVIJIMI I TË MENDUARIT

*Udhëzohen nxënësit që fillimisht të lexojnë njësinë mësimore nga libri dhe pastaj të përzgjedhin diagrame, në mënyrë që të organizojnë lidhje ndërmjet rezultateve të pritura të të nxënit. Mësimdhënësi/ja paraqet në letër të bardhë një model të diagramit (skemës). Nxënësit ndahen në grupe dyshe dhe punojnë duke shfrytëzuar burimet në dispozicion të informacioneve. Analizojnë dhe plotësojnë diagramin. Mësimdhënësi/ja mbështet punën nëpër grupe.*
*Pasi të ketë përfunduar komentimi i asaj që kanë shkruar i fton nxënësit të përcjellin në ekran një lidhje hierarkike të organizmit.*




*Pastaj u kërkon të vlerësojnë situaten nëse psh nga shembulli I thenë largojmë ndonjë organ, apo dhe qelizën, si do të funksiononte lidhshmëria logjike? Vazhdon me diskutimin se ku jeton organizmi, cfarë paraqesin disa individë të të njejtit lloj,si jetojnë ata në bashkësi jetësore, në ekosistem etj..*

## IMAGJINATË E DREJTUAR

*Pastaj shperndan në grupe nga një fletë të palosur dhe u kërkon atyre të shkruajnë nga një fjali që u mbet në kujtesë pasi lexuan materialin,dhe një fjali apo pyetje nëse kanë ende paqartësi. Fleta është e palosur ashtu që nuk mund ta shohin se cfarë ka shkruar shoku apo shoqja paraprakisht. Pastaj merr ato fleta dhe i lexon me zë të lartë në mënyrë që të gjithë të dëgjojnë dhe së bashku të vlerësojnë se cila fjali e përmbledhë më së miri njësinë mësimore.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Krijoni një rrjetë përmes së cilës paraqitni ndërtimin hierarkik të organizmave*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN E ORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës   Lënda: Biologji   Shkalla e kurrikulës: III   Klasa:VI | |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br>Biodiversiteti | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Krahason karakteristikat e organizmave brenda mbretërive të bimëve ose shtazëve (p.sh. krahason karakteristikat e një peshku dhe një gjitari, të një peme Gjethëmbajtëse halore dhe një peme gjethërënëse, të fiernave dhe bimëve me lule).* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):

**I-4**. *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit*

**II-6.** *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.*

**IV-7.***Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj).*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Karakteristikat e organizmit**

Fjalët kyçe: *organizem, lëvizje, oksigjen, ndjeshmëri, rritje, riprodhim.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan shtatë vecoritë e qenieve të gjalla duke treguar çfarë kupton me secilën prej tyre;*
*Përshkruan sekretimin si vecori te bimët dhe shtazët*
*Tregon veçoritë më të nevojshme që përcaktojnë nëse diçka është e gjallë ose jo e gjallë*

Kriteret e suksesit:

*Listo shtatë veçoritë kryesore të gjallesave*
*Jep shembuj konkretë për secilën veçori të lartëcekur*
*Përcakto cilat vecori janë tregues të saktë për të gjallën dhe jo të gjallën*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, figura etj.*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Art Figurativ*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

## DISKUTIM PËR NJOHURITË PARAPRAKE

*Mësimdhënësi/ja u paraqet nxënësve figurat e mëposhtme (robot, kukull, barbie, lodër njeri, njeri) dhe u kërkoj nxënësve të thonë një të përbashkët (kanë strukturë trupore të njëjtë) dhe një dallim (njeriu është qenie e gjallë, të tjerat jo të gjalla). Nga përgjigjet e tyre veçoj dy veçoritë (karakteristikat) që të interesojnë për mësimin. Pastaj pyet ata: Nga se i dallojmë qeniet e gjalla?*







*U kërkonë të përmendin disa nga proceset jetësore që kryejnë gjallesat (ata shprehen siç e mendojnë dhe nuk i korrigjon).*

## MARRËDHËNIET PYETJE - PËRGJIGJE

*Mësimdhënësi/ja jep shembuj se si të bëjmë dallimin mes të gjallës dhe jo të gjallës, i ndajmë nxënësit në grupe. Analizojmë dy vetura, njëra lodër që vihet në lëvizje me bateri, ndërsa tjetra, e cila lëviz me karburant (merr oksigjen dhe nxjerr lëndë të mbetura). Për të orientuar diskutimin mund të përdoren edhe pyetjet:*

*Ç' është jeta dhe çka e karakterizon atë?*

*A kanë nevojë bimët për oksigjen?*

*Marrim përgjigje nga secili grup dhe i shkruajmë në tabelë.*

## DISKUTIM

*Pastaj nxënësit lexojnë me hapa tekstin në faqen 18 dhe 19 dhe, pas çdo paragrafi diskutojnë, japin shembuj, ndërsa mësimdhënësi/ja plotëson shtatë veçoritë e së gjallës në dërrasë, në një skemë të ngjashme me të parën. Pasi përfundojnë, diskutojnë se cilat dhe sa prej veçorive fillestare që ata përmendën ishte e njëjtë me veçorinë shkencore për të dalluar një gjallesë, duke e nënvizuar / rrethuar në skemën e parë. I nxit ata të marrin shembuj gjallesash që nuk i plotësojnë të shtatë veçoritë (bimët nuk lëvizin).*

*U kërkon nxënësve të hartojnë tabelën "Lista e veçorive të së gjallës" në fletore, e cila do t'i ndihmojë ata në ushtrimet dhe në mësimet pasardhëse.*

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimor*

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Zgjedhni një karakteristikë të organizmave të gjallë dhe hulumtoni për të.*

## REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**Aktivitet shtesë:**

*Nxënësve u kërkohet të hulumtojnë në internet apo ndonjë material tjetër (si enciklopedi etj.) rreth organizmave të gjallë dhe gjësendeve jo të gjalla. Hulumtimin ta paraqesin në formë eseje me rreth 200 fjalë.*

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

**Tema ( nga– plani dymujor):**
Biodiversiteti

**Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):**
*Identifikon rregullat themelore të emërtimit, klasifikimit dhe kategoritë taksonomike të qenieve të gjalla. Klasifikon qeniet e gjalla në grupet kryesore taksonomike. Përdorë çelësa të thjeshtë dikotomik për identifikimin dhe klasifikimin e organizmave të gjallë. Hulumton organizmat e gjetur në një habitat specifik (oborr shkolle, park qyteti, kënetë, lum, pyll, livadh, etj,) dhe i klasifikon organizmat sipas sistemit të klasifikimit.*

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):**

**I-1.** *Lexon rrjedhshëm, me intonacion të duhur, një tekst të caktuar rrëfyes, përshkrues, shkencor a publicistik etj., dhe e komenton atë sipas kërkesës me gojë ose me shkrim.*

**I-3.** *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

**II-6.** *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.*

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sistematika klasifikimi i organizmave**

Fjalët kyçe: *klasifikim, shkurre, barishtore, binomial, farefisni.*

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

*Shpjegon historinë e klasifikimit të gjallesave duke filluar nga koha e Aristotelit*
*Tregon se çfarë ka për bazë sistemi i klasifikimit natyror*
*Vlerëson rëndësinë e sistemit të klasifikimit natyror*

**Kriteret e suksesit:**

*Trego si janë klasifikuar gjallesat derisa nuk përdorej sistemi i klasifikimit natyror*
*Jep së paku 3 shembuj të klasifikimit të gjallesave të bazuar në sistemin binomial*
*Përkufizo rëndësinë e përdorimit të sistemit të klasifikimit natyror*

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

*Libri “Biologjia 6, fotografi, tv, llaptop*

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

*Gjuhë dhe komunikim, Tik,*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

## SHKRIM I SHKURTËR,

*Në fazën e parë nxënësit individualisht bëjnë "një shkrim të shkurtër" për shtazët që i njohin në rrethinën e tyre. Pastaj emrat i shkruajmë në anën e majtë të tabelës, duke hulumtuar në internet, më vonë i vendosin emrat e shtazëve edhe në gjuhën latine.*

## LEXIM I AVANCUAR

*Lexohet teksti me pjesë pasi të jenë formuar grupe dyshe. Grupi i parë: nxënësit shkruajnë për historikun dhe emërtimet për organizma të ndryshëm bimorë dhe shtazorë. Grupi i dytë: shkruajnë për natyralistin Karl Linne. Grupi i tretë: shkruajnë për emërtimet e bimëve në gjuhën latine. Grupi i katërt: shkruajnë për emërtimet e shtazëve në gjuhën latine. Grupi i pestë: shkruajnë për gjinitë, familjet, klasat, tipat. Në fund, nga secili grup, përfaqësuesi i grupit i lexon shkrimet. Mani i bardhë - Morus alba. Mani i zi - Morus nigra Ujku - Canis lupulus*

*Pastaj vendos në ekran disa fotografi si këto:*







| | |
|---|---|
| **mbretëria**: | Plantae |
| **ndarja**: | Magnoliophyta |
| **klasa**: | magnoliopsida |
| **rendi**: | Rosales |
| **familja**: | Rosaceae |
| **gjinia**: | Pyrus |
| **lloji**: | Pyrus communis |

| | |
|---|---|
| **mbretëria**: | Plantae |
| **ndarja**: | Magnoliophyta |
| **klasa**: | magnoliopsida |
| **rendi**: | Rosales |
| **familja**: | Rosaceae |
| **gjinia**: | Malus |
| **lloji**: | Malus domestica |

| | |
|---|---|
| **Mbretëria** | Animalia |
| **Filumi** | Chordata |
| **Klasa** | Mammalia |
| **Rendi** | Carnivora |
| **Familja** | Canidae |
| **Gjinia** | Canis |
| **Speciet** | Canis lupus |

## PUNË KËRKIMORE

*Pas shfaqjes në ekran kanë për detyrë të gjejnë sistematikat (dardha , molla , ujku) Kurse dy grupet e tjera kanë për detyrë të gjejnë sistematikën e këtyre llojeve shtazore (qeni, vjedulla, rrushi) dhe për të përfunduar detyrën shfrytëzojnë llaptopin dhe internetin.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Hulumtoni sistematikën e disa nga llojet e preferuara bimore dhe shtazore*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**Aktivitet shtesë:**

*Ushtrime nga libri faqe 114 për përdorimin e çelësave dikotomik. Mlbledhni nga ambienti për rreth shtëpisë organizmat e gjetur dhe klasifikoni ata në bazë të rregullit të klasifikimit, sjellni në klasë dhe diskutoni me mësimdhënësin.*

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

**Tema ( nga– plani dymujor):**

**Biodiversiteti**

**Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):**

*Identifikon dhe përshkruan karakteristikat dalluese të grupeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët (pakurrizorët) nuk kanë shtyllë kurrizore; insektet kanë tri pjesë themelore të trupit; bimët me lule prodhojnë lule dhe fryte) dhe i përdorë këto karakteristika për klasifikimin e metejshëm të llojeve të ndryshme të bimëve dhe shtazëve (p.sh. invertebrorët- arthropodat- insektet; vertebrorët- gjitarët- primatë; bimët me fare- bimët me lule- bimët barishtore)*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I- 6**. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

**III-5**. *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

**IV7**. *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj).*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Mbretëritë e botë së gjallë**

Fjalët kyçe: *monerë, protistë, kërpudha, bimë, shtazë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përcakton mbretëritë e botës së gjallë*
*Përshkruan karakteristikat e organizmave për secilën mbretëri*
*Veçon tiparet dalluese të bimëve dhe shtazëve*

Kriteret e suksesit:

*Listo mbretëritë e botës së gjallë*
*Veço karakteristikat e protistëve, monerëve, kërpudhave, bimëve dhe shtazëve*
*Dallo përmes fotografisë tiparet e klasifikimit të bimëve dhe shtazëve*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, laptop, fotografi*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi, Art Figurativ*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

*Orën mësimore e fillon duke u kërkuar nxënësve që të imagjinojnë pamje (imazhe) të ndryshme: kafshë, bimë, kërpudha, protiste, prokariote. Për të ju ndihmuar pak nxënësve lidhur me imazhet e kërkuara shfaq në videoprojektor pamje të monerëve, protistëve, kërpudhave, bimëve dhe shtazëve. Nxënësit lihen për disa minuta të krahasojnë këto pamje, dhe të reflektojnë për informacionet e tyre.*













*Pasi të përfundojë reflektimi i nxënësve mbi atë që panë vazhdon me pjesën tjetër të orës.*

## GRUPET E EKSPERTËVE

*Zgjedhë të punosh përmes grupeve të ekspertëve, nxënësit ndahen në grupe pune, dhe cakton numrat nga 1-5 për secilin nxënës të cdo grupi, u caktoj të orientohen në libër dhe të lexojnë secili nxënës nga një mbretëri.*

*Pasi nxënësit të kenë kuptuar pjesën e tyre, fton që në një grup të bashkohen numrat 1- nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër 2, në grupin tjetër 3-shat, në grupin tjetër 4-shat, në grupin e fundit 5-shat. Kështu të bashkuar fton nxënësit të diskutojnë në mes tyre lidhur me atë çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione ti shkëmbejnë me njëri tjertin. Pas pak minutash fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prap për atë çfarë mbajten në mend secili për pjesën e tyre.*

## DISKUTIMI

*Pasi të mbarojë diskutimi për disa minuta fton nxënësit të fillojnë diskutimin së bashku, duke i ndihmuar me pak pyetje për orientim .*

*Fillimisht udhëzon nxënësit të listojnë mbretëritë e botës së gjallë, duke filluar nga organizmat më të thjeshtë e deri te ata më të ndërlikuar siç janë shtazët. Pastaj fton nxënësit që ishin të emëruar si 1-sha të përshkruajnë vecoritë e monerëve, kush bënë pjesë në këtë mbretëri dhe ndonjë karakteristikë. Pastaj një nxënës tjetër të emëruar më pare si 2-shi, të na sqarojë mbretëritnë e protistëve, kush bënë pjesë në këtë mbretëri, cilat janë mënyrat e të ushqyerit të algave etj. Pastaj vazhdon me një përfaqësues të 3-shave për të treguar për mbretërinë e kërpudhave, kush bënë pjesë në to, si ndahen kërpudhat sipas mënyrave të ushqimit etj. Pastaj vazhdon me grupin e 4-shave të flasin për mbretërinë e bimëve duke vënë në pah vecoritë dalluese të bimëve, fillimisht duke vecuar se janë organizma shumëqelizor, pastaj që kryejnë procesin e fotosintezës, si ndahen në bazë të mënyrës së shumimit etj.. Vazhdonë me grupin e fundit, por jo më pak të rëndësishmin me grupin e 5-shave, mbretërinë e shtazëve, fton nxënësit të shpalosin njohuritë e fituara për veçoritë dalluese të shtazëve, pra dy grupet më të mëdha kurrizorë dhe jo kurrizorë, duke u shërbyer me fotografi përkatëse, pastaj numërojnë disa përfaqësues për secilën kategori.*

### VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimor*

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Pyetjet nga libri faqe 28*

### REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI |
|---|---|---|---|

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Biodiversiteti** | *Demonstron të kuptuarit e biodiversitetit si llojllojshmëri e jetës në Tokë, duke përfshirë llojllojshmërinë brenda secilës specie, ndërmjet specieve të bimëve dhe shtazëve në bashkësi jetësore, si dhe ndërmjet bashkësive jetësore dhe peisazhit fizik që i mbështet ato.*<br><br>*Diskuton arsyet e zvogëlimit dhe zhdukjes së disa bimëve ose shtazëve (p.sh. për shkak të gjuetisë së tepruar, sëmundjeve, llojeve invasive, ndryshimeve dhe shkatërrimeve të habitatit).*<br><br>*Shpjegon rëndësinë e biodiversitetit për stabilitetin e ekosistemeve natyrore dhe përfitimet e njeriut nga biodiversiteti (sigurimin e resurseve jetësore si ushqimi, barnat, lëndët e para për prodhime të ndryshme etj.).* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I 3.** *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

**I 2.** *Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.*

**III 1.** *Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Biodiversiteti- vlera më e lartë e natyrës**

Fjalët kyçe:*lloje endemike, rreqebulli, ylli shqiptar, lloje endemorelikte*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Sqaron shkaqet që qojnë në shkatrrimin e Biodiversitetit*
*Identifikon bimët dhe shtazëtendemike të rrezikuara për zhdukje në vendin tonë*
*Liston masat për ruajtjen e llojeve bimore e shtazore të rrezikuara në vendin tonë.*

Kriteret e suksesit:

*Numëro të paktën 3 praktika të përditshme që shatrrojnë Biodiversitetin*
*Përmend disa lloje bimore dhe shtazore të listuara në listen e kuqe të llojeve të rrezikuara*
*Shjego disa nga masat për ruajtjen e Biodiversitetit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Material i përgaditur nga nxënësit, libri Biologjia 6*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologji*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

*Orën mësimore e fillon duke u kërkuar nxënësve të përcjellin në ekran disa fotografi, si më poshtë:*











*Pasi nxënësit përcjellin me vëmendje fotografitë, i fton ata të komentojnë se çfarë kuptuan. Pastaj merr mendime të ndryshme nga nxënësit, deri sa të arrijnë të zbulojnë temën për sot Biodiversiteti-vlera më e lartë e natyrës .*

LUAJTJA E ROLEVE

*Kështu vazhdojnë të punojmë përmes roleve, mësimdhënësi/ja ndanë për secilin nxënës nga një paragrafë të shkurtë në mënyrë që të kenë mundësinë secili nga ta të përvetësojë lehtë informacionet. Pasi kanë mbaruar me leximin dhe sqarimin e pjsëve të tyre, i fton të fillojmë me luajtjen e roleve. Merr me vete një top të lidhur me një pe. Nga secili grup paraprakisht ka emërtuar nga 1deri te 6. Fton nxënësin e parë që për detyrë kishte të lexonte llojet e larmisë, fillon diskutimi për pjesën e tij, të tjerët dëgjojnë dhe kanë për detyrë të gjejnë se për cfarë po diskuton, pastaj vazhdon me nxënësin e dytë i cili kishe lexuar përfitimet ekonomike, i cili tani shpjegon se çfarë janë përfitimet ekonomike dhe i numëron disa nga to, pasi të mbarojë pjesën e tij dikush nga klasa ka për detyrë të qëlloj se për cilat përfitime po bëhet fjalë dhe ai që e qëllon del dhe e merr fjalën për pjesën e tij. Kështu vazhdojmë deri sa të prezantoj edhe nxënësi i fundit. Në këtë mënyrë të gjithë nxënësit do të përfshihen në realizimin e ores mësimore.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Hulumtoni për biodiversitetin e Kosovës*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**Aktivitet shtesë:**

*Hulumtoni në internet faqen e një parku kombëtar ose rezervati natyror, gjeni shembuj të bimëve dhe shtazëve të mbrojtura si dhe lokalizoni biotopin e tyre.*

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):
**Biodiversiteti**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):
*Identifikon produktet e jetës së përditshme të cilat kanë origjinë nga diversiteti i organizmave (p.sh. mëndafshi nga krimbi i mëndafshit, suplementët ushqimor, shamponët, pastat e dhëmbëve dhe dezodorantët që përmbajnë polen të mbledhur nga bletët etj.).*

*Vlerëson përfitimet që ka shoqëria njerëzore nga biodiversiteti si dhe problemet që shkaktohen nga zvogëlimi i biodiversitetit.*

*Identifikon bimët dhe shtazët endemike, të rrezikuara për zhdukje, që jetojnë në Kosovë. Identifikon mënyrat për mbrojtje të llojeve bimore dhe shtazore të rrezikuara në Kosovë.*

*Analizon një çështje lokale të lidhur me biodiversitetin (p.sh. efektet e aktiviteteve të njeriut në biodiversitetin urban). Vlerëson rolin dhe ndikimin e njeriut në ruajtjen dhe zhvillimin e biodiversitetit- nivel global.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I 3.***Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim*

**II 1.** *Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie*

**III-5.** *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Biodiversiteti i Kosovës**

Fjalët kyçe: *lloje endemike, rreqebulli, ylli shqiptar, lloje endemorelikte*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Sqaron shkaqet që qojnë në shkatrrimin e Biodiversitetit*
*Identifikon bimët dhe shtazët endemike të rrezikuara për zhdukje në vendin tonë*
*Liston masat për ruajtjen e llojeve bimore e shtazore të rrezikuara në vendin tonë.*

Kriteret e suksesit:

*Numëro të paktën 3 praktika të përditshme që shkatrrojnë Biodiversitetin*
*Përmend disa lloje bimore dhe shtazore të listuara në listen e kuqe të llojeve të rrezikuara*
*Shpjego disa nga masat për ruajtjen e Biodiversitetit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Material i përgaditur nga nxënësit, libri Biologjia 6, fotografi, laptop, projektor*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologji*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM PËR NJOHURITË PARAPRAKE

*Në këtë fazë të orës evidentohen njohuritë paraprake të nxënësve, e cila shërben edhe si vlerësim diagnostikues dhe mbi këto dije ndërtohet përmbajtja e re, e cila i motivon ata për të mësuar më shumë rreth biodiversitetit.*

GRUPET E EKSPERTËVE

*Mësimdhënësi/ja zgjedhë të punojë me grupet e ekspertëve udhëzon nxënësit të hapin librat dhe të lexojnë pjesë të caktuara nga libri, por do të shërbehen edhe me material shtesë të përgaditur më pare nga nxënësit, (pasi kjo u është kërkuar më parë nxënësve si detyrë shtëpie). Nxënësit ndahen në grupe pune , dhe cakton numrat nga 1- 6 për secilin nxënës të çdo grupi, u cakton të orientohen në libër dhe të lexojnë secili nxënës nga një pjesë. Pasi nxënësit të kenë kuptuar pjesën e tyre, ftoj që në një grup të bashkohen numrat 1- nga të gjitha grupet, pastaj në grupin tjetër numrat 2, në grupin tjetër 3-shat, në grupin tjetër 4-shat, në grupin e fundit 6-shat.*

*Kështu të bashkuar fton nxënësit të diskutojnë në mes tyre lidhur me atë çfarë lexuan, sa kanë mbajtur në mend, dhe këto informacione ti shkëmbejnë me njëri tjertin. Pas pak minutash fton nxënësit të kthehen në grupet e tyre fillestare dhe aty të diskutojnë prap për atë çfarë mbajten në mend secili për pjesën e tyre.*

*Pasi të mbarojë diskutimi për disa minuta fton nxënësit të fillojmë diskutimin së bashku, duke u ndihmuar me pak pyetje për orientim .*

DISKUTIMI

*Fillojnë diskutimin, një përfaqësues i grupit të parë fillon të prezantoj fillimisht atë çfarë ka mbajtur në mend, të tjerët shtrojnë pyetje, kështu vazhdohet me të gjitha grupet deri sa të përfundojë i gjithë diskutimi. Deri sa nxënësit diskutojnë në ekran shfaqen llojet biomore e shtazore të rrezikuara në vendin tone..*





VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi individual dhe grupor gjatë punës kërkimore, vlerësimi i detyrave të shtëpisë*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Pyetjet nga libri faqe 38*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**Aktivitet shtesë:**

*Rekomandoni nxënësit të lexojnë literaturë dhe të shfrytëzojnë internetin për më shumë informata lidhur me biodiversitetin e Kosovës, llojet endemike, rrezikun e zhdukjes. Kërkoni nga nxënësit të shkruajnë një përmbledhje nga ajo që kanë hulumtuar dhe t'i lexojnë e komentojnë në klasë.*

**Periudha e I**

**Nëntor-Dhjetor**

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):

**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):

*Definon nocionet/termat themelore ekologjike.*
*Diskuton efektin në organizma kur mjedisi bëhet i pafavorshëm (organizmi përshtatet dhe mbijeton, zhvendoset në një vend tjetër ose vdes).*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I- **4.** *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit*

II- **6.** *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim*

III- **3.** *Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*
*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Organizimi i qenieve të gjalla**

Fjalët kyçe:*ekologji, faktorë ekologjikë, përshtatje, organizma*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Definon termin Ekologji*
*Shpjegon shprehjen "mjedis jetësor"*
*Përshkruan përshtatjen e organizmave ndaj ndikimeve të mjedisit të jashtëm.*

Kriteret e suksesit:

*Trego si janë marrëdhëniet e qenieve të gjalla me mjedisin*
*Jep shembuj të mbijetesë, apo zhvendosjes së organizmave si rezultat i ndikimit të mjedisit*
*Dallo ndikimet (faktorët ekologjikë) abiotik dhe biotik.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DIL RROTULL - FOL RROTULL

*U kërkohet nxënësve të mendojnë për dy minuta rreth asaj çka paraqesin: Faktorët abiotik dhe biotik. Ngrihen nxënësit nga bankat dhe shkojnë në një vend të hapur të klasës. Ata do të ecin në hapësirë derisa mësimdhënësi/ja përplas duart. Në këtë çast nxënësit ndalen dhe flasin për atë që menduan pak më parë me personin ngjitur në lidhje me pyetjen e shtruar. Pasi nxënësit ulen, u kërkohet disave prej tyre të thonë mendimet e tyre para klasës. Ata edhe mund*

*të kenë pyetje. Shkruhen mendimet dhe pyetjet në një tabelë. Nxiten nxënësit në diskutim e orientohen në përcaktimin e konceptit "Faktorë të gjallë dhe jo të gjallë".*

## LEXIM DHE PYETJE,

*Pas diskutimit të zhvilluar në fazën e parë, mësimdhënësi/ja shtron pyetjet: Si formohen stinët? Cili është shkaku? Ç'ndodh tjetër? Njëkohësisht mësimdhënësi/ja i fton nxënësit për të gjetur përgjigjet e duhura, duke lexuar tekstin. Ndahet teksti në paragrafë. Nxënësit do të punojnë në dyshe. Ata do të lexojnë paragrafët e do të vendosin së bashku se cilat janë termat kryesorë. Këta terma do t'i shkruajnë anash tekstit. Pasi nxënësi i parë mbaron së lexuari paragrafin e parë, nxënësi i dytë bën pyetje për tekstin, duke përdorur termat e shkruar anash. Nxënësi i dytë e shkruan pyetjen në skedë të vogël. Pasi nxënësi i dytë bie dakord me përgjigjen e nxënësit të parë, ata e shkruajnë atë në pjesën e pasme të skedës. Vazhdohet duke këmbyer rolet derisa të lexohet i gjithë teksti. Mësimdhënësi/ja ndalon nxënësit pas leximit të paragrafit të parë, rishikon termat, pyetjet, përgjigjet e sugjeron korrigjime. Vepron kështu në përfundim të leximit të çdo paragrafi sa herë e sheh të arsyeshme.*

## RJEDHSHMËRIA GOJORE E DYSHES

*Nxënësit do të punojnë në dyshe për të "përmbledhur" atë që lexojnë e mësojnë. Nxënësi 1 për 60 sekonda do t'i tregojë shokut diçka që mban mend nga pjesa që lexoi. Për 1 minutë nxënësit ndërrojnë rolet. Tani, nxënësi 2 do t'i tregojë shokut ç'gjë interesante mësoi, por duke u kujdesur të mos përsëritë ato çka i tha shoku. Vazhdohet kështu për 40 sekonda, 20 sekonda etj. (koha përcaktohet nga mësuesi). E rëndësishme është që nxënësit të rishikojnë materialin dhe të pyesin nëse kanë paqartësi.*

## VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime)*

## DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Hulumtoni për përshtatjen e organizmave të ndryshëm me kushtet e mjedisit jetësor*

## REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës    Lënda: Biologji    Shkalla e kurrikulës: III    Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Identifikon faktorët të cilët ndikojnë në ekzistencën e një organizmi- karakteristikat fizike të mjedisit (temperatura, drita, uji), disponueshmëria e ushqimit- tipet e organizmave tjerë të pranishëm (prodhuesit, konsumuesit, shpërbërësit).* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I- 6.** *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

**I- 3.** *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Çka kuptohet me mjedis?**

Fjalët kyçe:*drita, temperature, abiotik, biotik, faktorë ekologjikë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Identifikon faktorët ekologjikë biotik dhe abiotik*
*Liston faktorët ekologjikë abiotik*
*Numëron faktorët ekologjikë biotik*

Kriteret e suksesit:

*Defino konceptin faktorë ekologjikë*
*Dallo faktorët ekologjikë biotik nga ata abiotik*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, projector, llaptop( video), tabela*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

MENDO SHUMË SHKRUAJ SHKURT

*Orën mësimore e mësimdhënësi/ja e fillon duke ju kërkuar nxënësve të plotësojnë konceptin "Faktorë Ekologjikë" me fjalët që kanë mësuar dhe tashmë dijnë për faktorët ekologjikë dhe Ekologjinë në përgjithësi.*
*Kështu psh:*
*FAKTORË EKOLOGJIKË-psh me shkronjën T- temperature, K- klima, etj..*
*Pasi të kenë mbarur detyrën e kërkuar, fton nga një përfaqësues të grupeve të tregojnë dhe njëkohësisht të plotësojnë të njejten në tabelë.*

**FAKTORË EKOLOGJIKË**

| | |
|---|---|
| ***O*** | ***L*** |
| ***K*** | ***I*** |
| ***A*** | ***M*** |
| | ***A*** |

*shembull:*

DRTA

*Pasi të kenë mbaruar, fton nxënësit të hapin librat faqe 41, dhe të lexojnë në fillim paragrafin e parë, pas leximit mbyllin librat dhe e komentojnë atë çfarë e kanë lexuar, apo edhe mbajtur në mend, kështu veprohet deri sa të mbaroj komentim i të gjitha pjesëve nga libri.*

TABELA PËRMBLEDHËSE

*Në tabelën përmbledhëse shënohen dy kolona në njërën faktorët biotik e në tjetrën faktorët abiotik, në formë përmbledhje.*

| ***Faktorët ekologjikë biotikë*** | ***Faktorët ekologjikë abiotikë*** |
|---|---|
| | |

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Rekomandoni nxënësit të përcjellin video informuese për faktorët ekologjikë dhe të reflektojnë për atë që shikuan.*

https://www.youtube.com/watch?v=iOh7KdEBCCA

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):

**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):

***Bënë dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.- Organizmi është qenie e gjallë.-*** *Popullata definohet si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të vaçantë.* ***Shfrytëzon organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.***

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I- 6.** *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

**II- 8.** *Përdorë krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.*

**IV 7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Biosfera dhe njësitë që e përbëjnë atë**

Fjalët kyçe:*individë, popullatë,komunitet, biom, ekosistem, biosferë*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Definon termin ekositem*
*Dallon konceptet individë dhe popullatë*
*Përshkruan organizimin e qenieve të gjalla në biosferë*

Kriteret e suksesit:

*Përshkruaj ndërtimin e ekosistemit*
*Krahaso individët nga popullata dhe komunitetin nga shoqëria*
*Paraqit grafikisht organizimin e qenive të gjalla në biosferë*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, projektor, llaptop( fotografi), fotografi të printuara, ngjitës*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi, Art Figurativ*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

## IMAGJINATË E DREJTUAR

*Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve të qëndrojnë në heshtje dhe të mendojnë si bëhet jeta në univers. U kërkohet të ëndrojnë kështu për rreth 2 minuta. Mësimdhënësi/ja drejton pyetjet: Si ndërtohet një ekosistem? (ndërtohet nga dy përbërës: biotop dhe biocenozë). Lihen nxënësit të lirë të thonë atë çka ata shohin me sytë e mendjes, pa ndërhyrë apo komentuar.*

## DRTA OSE LEXIM I DREJTUAR

*Nxënësit lexojnë titullin dhe japin mendime e parashikime për përmbajtjen e paragrafit të parë (ndërtimin e ekosistemit), duke i argumentuar ato. Pasi lexojnë paragrafin e parë, ata krahasojnë përmbajtjen e tij me parashikimin e tyre. Vazhdohet kështu me gjithë tekstin. Mësimdhënësi/ja kujdeset për të sqaruar konceptet kryesore gjatë leximit me ndalesa. Diskutohet rreth informacionit të marrë në tekst dhe informacioneve të sjella nga vetë nxënësit*.

## SHKRIM I SHPEJTË

*Në fundin e orës nxënësit do të shkruajnë shumë shkurt dhe shumë shpejt në lidhje me temën "Biotopi, biocenoza dhe ekosistemi"(punë në dyshe). Në këtë shkrim nxënësit do të përmbledhin mendimet në lidhje me temën dhe informacionin që morën (ndërkohë në ekran do të shfaqen kohë pas kohe këto figura që të u ndihmojnë të inspirohen gjatë shkrimit të shpejtë) Disa nxënës lexojnë shkrimet e tyre. Mësimdhënësi/ja do të përqendrohet në idetë e hedhura në letër, e jo në paraqitjen e shkrimit. (Mënyrën si po e shkruajnë: me gabime apo me shkrim të parregullt). Jepet një fjali e pambaruar si temë.*








| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| *Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Hulumtim për organizimin e qenieve të gjalla në mjedis* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI |

| | |
|---|---|
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Përshkruan ndërtimin dhe funksionimin e ekosistemit.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I2. *Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.*

I- 6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

II-6. *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Funksionimi i ekosistemit**

Fjalët kyçe:*ekosistem, prodhues, konsumues, zbërthyes, zinxhirë ushqimor.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan funksionimin e ekositemit*
*Dallon zinxhirin ushqimor nga rrjeta ushqimore*
*Vlerëson rolin niveleve trofike*

Kriteret e suksesit:

*Numëro nivelet trofike në ekosistem*
*Jep të paktën një shembull të një zingjirit ushqimor*
*Sqaro cfarë ndodhë me ekosistemin nëse i largojmë psh zbërthyesit.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, llaptop, projector, fotografi.*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi, Art Figurativ*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAGJINATË E DREJTUAR

*Orën mësimore mësimdhënësi/ja fillon duke paraqitur në tabelë (ekran) një fotografi, dhe nga nxënësit kërkoj të bëjnë një përshkrim të shkurtë në fletoret e tyre, lidhur me atë se qfarë shohin.*



*Pasi nxënësit t'i kenë përfunduar së shkruari mendimet e tyre, kërkon nga ata t'i lexojnë shkrimet pa u konfirmuar atyre ose kundershtuar mendimet.*

DRTA OSE LEXIM I DREJTUAR

*Pasi lexojnë paragrafin e parë, ata krahasojnë përmbajtjen e tij me parashikimin e tyre. Vazhdohet kështu me gjithë tekstin. Mësimdhënësi/ja kujdeset për të sqaruar konceptet kryesore gjatë leximit me ndalesa.*

DISKUTIM

*Pasi të kenë përfunduar leximin fillon diskutimi, diskutimin e orienton mësimdhënësi-ja duke ftuar nxënësit të japin shembuj të rrjetave ushqimore, dhe sqarojnë se çfarë do të ndodhë nëse nga ekosistemi largojmë kosumuesit, poashtu nëse largojmë prodhuesit apo edhe zbërthyesit.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informata kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Nxënësit i udhëzojmë që në mënyrë individuale të hulumtojnë lidhur me zinxhirët ushqimorë. Hulumtimi apo punimi i tyre mund të mbështet në ndonjë punim paraprak, në libër, internet, broshurë.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):

**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):

*Përshkruan shndërrimin e energjisë gjatë zbërthimit të lendëve ushqyese në shembullin e zinxhirit të ushqimit duke shpjeguar nocionet prodhuesit dhe konsumuesit.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I2. *Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.*

I- 6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

II-6. *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Qarkullimi ciklik i materieve në ekosistem**

Fjalët kyçe:*materie organike, materie joorganike, ujë, oksigjen, riciklim*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan qarkullimin e materieve në ekosistem*
*Trgon rolin e konsumuesve në ekosistem*

Kriteret e suksesit:

*Përshkruaj qarkullimin e ujit në ekosistem*
*Jep të paktën një shembull të qarkullimit të materies në ekosistem*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, laptop, projektor, fotografi.*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi, Art Figurativ*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

STUHI MENDIMESH,

*U jepet nxënësve në tabelë tema "Qarkullimi i materies". Nxiten ata për të shkruar të gjitha mendimet që kanë në fletët e tyre. Më pas mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë të gjitha idetë e nxënësve. Pranohen të gjitha idetë e nxënësve, edhe nëse nuk janë shumë të qarta ose shumë të sakta. Nxiten nxënësit të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri- tjetrit.*

LEXIM I DREJTUAR

*Lexohet titulli "Qarkullimi i energjisë në ekosistem" dhe nxënësit japin parashikimin për pjesën që vjen. Pastaj lexohet paragrafi dhe bëhet krahasimi me parashikimin. Kështu vazhdohet dhe për paragrafët e tjera deri në fund. Parashikimi në këtë faqe bëhet duke u nisur nga piramida ekologjike (konsumuesit e rendit I, II, III).*

## SHKRIM I SHPEJTË

*Shkruhet tema "Qarkullimi i materies në ekosistem" dhe nxënësit për një kohë të shkurtër (3-4 minuta) shkruajnë: çfarë mësuan rreth temës. Lexohen disa prej punimeve të tyre dhe komentohen ato nga nxënësit. Nxënësit udhëzoni të plotësojnë fletoren e punës*

| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
| --- |
| *Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)* |
| **DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR** |
| *Nxënësit udhëzohen që në mënyrë individuale të hulumtojnë lidhur me qarkullimin e materies në ekosistem.* |
| **REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE** |
| |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës   Lënda: Biologji   Shkalla e kurrikulës: III   Klasa:VI | |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Përshkruan shndërrimin e energjisë së dritës në energji kimike gjatë krijimit të lëndëve ushqyese në shembullin e fotosintezës duke mos u shërbyer me simbole kimike në pasqyrimin e ekuacionit të fotosintezës. Gjurmon rrugën e energjisë prej Diellit nëpër qeniet e gjalla dhe identifikon rolet e organizmave të ndryshëm (prodhuesëve, konsumuesëve, grabitqarëve, presë) në zinxhirin e ushqimit dhe në rrjetën e ushqimit.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I-3.** *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

**II- 1.** *Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.*

**II-6.** *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Qarkullimi i energjisë në ekosistem**

Fjalët kyçe:*energji, pyramidë ekologjike, diell, fotosintezë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan qarkullimin e energjisë në eksositem*
*Shpjegon procesin e fotosintezës*
*Sqaron piramidën ekologjike*

Kriteret e suksesit:

*Interpreto qarkullimin e energjisë në ekosistem bazuar në fotografi*
*Paraqet në mënyrë grafike procesin e fotosintezës*
*Krijo një piramidë ekologjike*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, llaptop, projector, fotografi.*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi, Art Figurativ*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

RIKUJTIM I NJOHURIVE PARAPRAKE

*Orën mësimore e fillon duke rikujtuar njohuritë nga ora e kaluar për qarkullimin e materieve në ekosistem. Pastaj vazhdon duke udhëzuar nxënësit të përcjellin një video të shkurtër informuese që tregon qarkullimin e energjisë në*

*ekosistem duke përfshirë edh e fotosintezën.* https://www.youtube.com/watch?v=yHVhM-pLRXk

LEXO-KOMENTO

*Pasi nxënësit të përcjellin me vëmendje videon i udhëzon ata që të lexojnë në heshtje njësinë mësimore faqe 51. Pasi të kenë mbaruar leximin e njësisë mësimore i fton ata të fillojnë me komentimin e asaj që lexuan dhe shikuan paraprakisht në video.*

*Diskutimin e orienton mësimdhënësi-ja duke i udhëzuar nxënësit me pyetjet si: Përshkruaj qarkullimin e energjisë në ekosistem, çfarë ndodhë me energjinë gjatë procesit të fotosintezës, çfarë kuptoni me piramidën ekologjike, kush e ndërton bazën e piramidës ekologjike etj?*

*Pastaj fton ata të komentojnë se çfarë po kuptojnë nëse vëzhgojnë me vëmendje figurën në libër?*

*Në të cilën shihet qarkullimi i energjisë diellore në ekosistem, si dhe procesi i fotosintezës, të cilën e kryejnë bimët duke shfrytëzuar energjinë e diellit dhe duke shfrytëzuar dioksidin e karbonit dhe ujin dhe duke kriijuar sheqer- energji dhe oksigjen.*

*Pasi të ketë mbaruar komentimi i njësisë mësimore i udhëzon nxënësit të krijojnë nga një shembull të piramidës ekologjike, duke shfrytëzuar mjetet që kanë në klasë, qoftë edhe permes vizatimit.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informata kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Krijoni një piramidë ekologjike me mjetet e ndryshme shtëpiake*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

**Tema ( nga– plani dymujor):**

**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

**Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):**

*Bënë dallimin mes termave organizëm, popullatë dhe bashkësi jetësore.- Organizmi është qenie e gjallë.- **Popullata definohet si grup i bimëve ose shtazëve të llojit të njëjtë që jetojnë dhe riprodhohen në një vend dhe kohë të caktuar. Bashkësia jetësore përbëhet nga shumë popullata të cilat jetojnë në një vend të veçantë**.*

**Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.**

**I-3.** *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

**I- 4.** *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit*

**II- 8.** *Përdor krahasimin dhe kontrastin për të gjetur dallimet dhe ngjashmëritë kryesore midis dy e më shumë dukurive natyrore dhe shoqërore, krijimeve letrare apo artistike.*

**Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :**

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Ekologjia e popullatave**

Fjalët kyçe:*populate, individë, emigrim, imigri, lindhshmëri*

**Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:**

*Dallon individët nga popullata*
*Liston faktorët që ndikojnë në madhësinë e popullatës*
*Sqaron pse disa shtazë kanë aftësi më të mëdha riprodhuese dhe cilësi më të vogël*

**Kriteret e suksesit:**

*Krahaso popullatën e peshqëve me atë të shpendëve*
*Sqaro të gjithë faktorët që ndikojnë në madhësinë e popullatës*
*Trego përmes shembujve si ndikon madhësia e shtazëve në numrin e pasardhësve.*

**Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:**

*Libri Biologjia 6, tabela..*

**Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:**

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi, Ekologji*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

*Mësimi fillon me një pamje të një diagrami, ku tregohet rritja e individëve të disa gjallesave; Vështroni pamjen: Cili prej individëve ka rritje më të shpejtë? Përgjigje të mundshme: insektet, peshqit, krimbat (përgjigjet i shkruajmë në kolonën"DI"*

*Në kolonën "Dua të di" i vendosim pyetjet: Madhësia e popullatës varet nga? Cilat popullata kanë rritjen më të shpejtë të individëve? Pas kësaj mësimdhënësi/ja u përgjigjet pyetjeve të renditura më lart, por edhe të tjerave që mund t'i drejtojnë nxënësit. Në varësi të përgjigjes, e saktë apo jo, e qartë apo e paqartë, mësimdhënësi/ja shpjegon dhe jep shembuj për pyetjet më lart( apo edhe pyetje të tjera çfarë nxënësit nuk dinë)*

*Pasi kemi përfunduar kolonën"Dua të di", mësimdhënësi/ja plotëson kolonën e tretë të saj: Mësova. (Kontrolli i të kuptuarit si pjesë e konsolidimit të të nxënit kryhet me veprimtari në dyshe, nxënësit diskutojnë me njëri-tjetrin).*

*Shembull;*

| DI | DUA TË DI | MËSOVA |
| --- | --- | --- |
| | *Proceset demografike* | |
| | *Cilësia e vendjetesës* | |
| | *Marrëdhënia brenda llojit dhe ndërmjet llojit* | |
| | *Grabitshmëria* | |
| | *Sëmundjet* | |

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informata kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Hulumtoni në internet, cilat popullata rriten më shpejt (shembujt t'i sjellin në klasë).*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):

**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):

*Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim)*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I- 4.** *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit*

**III 1.** *Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën*

**III-5.** *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Ndërveprimet mes qenieve të gjalla**

Fjalët kyçe:*konkurrenca, grabitshmëria, parazitizmi, simbioza, neutralizmi*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Sqaron ndërveprimet në mes qenieve të gjalla*
*Dallon konceptet konkurrencë brendallojore dhe ndërllojore*
*Përshkruan grabitshmërin dhe parazitizmin*

Kriteret e suksesit:

*Krahaso ndërveprimet e dëmshme dhe të dobishme*
*Jep shembuj të konkurrencës brendallojore dhe ndërllojore*
*Krahaso grabitshmërin nga parazitizmi*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, llaptop, projector (video), tabela*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi, Ekologji*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

PËRMBLEDHJA E STRUKTURUAR

*Mësimdhënësi/ja flet shkurt rreth qenieve të gjalla. Sot do të mësojmë: Si t'i përshkruajmë mënyrat e ndërveprimeve mes organizmave (qenieve të gjalla)? Shpjegojmë pse konkurrenca mes llojeve çon në zhdukje? A ekzistojnë konkurrencat brenda llojit? Për të gjitha këto do të japim përgjigje në mësimin e sotëm. Sigurisht, gjatë kësaj faze nxënësit nxiten të bëjnë pyetje.(fotografitë shfaqen në ekran,ndihmojnë drejtimin e imagjinatës).*

 

PËRVIJIMI I TË MENDUARIT

*Mësimdhënësi/ja përgatit skeda me çështjet kryesore ose i shkruan ato në dërrasë të zezë. Mënyrat e ndërveprimeve të qenieve të gjalla mund të jenë të dëmshme dhe të dobishme. Çfarë lloji marrëdhënieje ka luani dhe bualli? Çfarë lloji marrëdhënieje ka leopardi dhe antilopa? Çfarë lloji marrëdhënieje ka eshka me ahun? Çfarë lloji marrëdhënieje ka flutura me lulen? Nxënësit lexojnë me vëmendje tekstin në bazë të çështjeve të mësipërme dhe në grupet e tyre përkatëse dhe përpiqen të ndërtojnë skemat e tyre rreth materialit që studiojnë. Mësimdhënësi/ja ndjek nga afër punën e grupeve dhe udhëzon si të bëjnë lidhjet brenda materialit. Ata mund të përdorin rrathë, shigjeta, katrorë etj. Kështu pasi grupet prezantojnë punën e tyre, mësimdhënësi/ja shënon përmbledhjen në tabelë.*

DIAGRAMI I VENIT

*Pastaj u kërkon nxënësve të punojnë në grup një diagram të venit në të cilin më së miri mund ti shohin dallimet dhe të përbashkëtat e konkurrences ndërllojore dhe brendallojore. Pastaj po të njejtin e punojnë edhe në tabelë, duke marrë mendime nga secili grup. Në këtë mënyrë arrijnë përfundimin e orës mësimore.*




| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| *Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Hulumtoni në internet ndonjë shembull (simbiozë) bashkëveprimi mes qenieve të gjalla.* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

**Periudha e II**

**JANAR- SHKURT- MARS**

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):

**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):

*Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim) Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh. ujqit udhëtojnë në grup për të mbrojtur territorin e tyre, rrisin të vegjëlit (këlyshët) e tyre dhe gjuajnë prenë e madhe).*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I-** **6.** Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.

**IV** **7.** Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj .

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sjelljet e shtazëve**

Fjalët kyçe: *Territor, komplekse, etologji, sjellje*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan mënyrat e sjelljeve të shtazëve.*

*Shpjegon sjelljet e lindura, të thjeshta dhe komplekse.*

*- Shpjegon sjelljet e fituara dhe ato të arsyeshme.*

Kriteret e suksesit:

*Krahason sjelljet e lindura, të thjeshta dhe komplekse*

*Jep të paktën tre shembuj të sjelljeve të lindura dhe të fituara të shtazëve*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Tik, Gjeografi,*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MINILEKSION

*Mësimdhënësi prezanton sjelljet e lindura dhe të fituara me shembuj vizualë. U themi nxënësve t'i shikojnë librat, pastaj i pyesim nxënësit se çfarë lloji i sjelljeve është paraqitur në shembujt vizualë*

DRTA

*Udhëzoi nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në libër për 10', pastaj parashtrojmë pyetjet: Përmendi disa sjellje instinktive të shtazëve? Sqaro sjelljet e lindura dhe të fituara të shtazëve? Çka kuptojmë me fjalën "dresurë"? Përgjigjet i shkruajmë në tabelë.*

KLLASTER

*Kërko nga nxënësit të plotësojnë në grupe një kllaster, me qëllim që t'i ndajnë sjelljet e shtazëve. Në fund nxënësve u kërkojmë të arrijnë një përkufizim rreth sjelljeve. Mbahen shënime nga të gjithë nxënësit e grupeve për sjelljet e lindura, të fituara dhe të arsyeshme. Kllasteri prezantohet para klasës. Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletoren e punës.*

| |
|---|
| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
| *Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Nxënësve u kërkohet të hulumtojnë për dresimin e shtazëve.* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI |
|---|---|---|---|

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim) Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh. ujqit udhëtojnë në grup për të mbrojtur territorin e tyre, rrisin të vegjëlit (këlyshët) e tyre dhe gjuajnë prenë e madhe).* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I-** **6.** *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

**II-** **1.** *Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie*

**IV** **7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*
*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sjelljet bashkëvepruese të shtazëve**

Fjalët kyçe: *Territor, bashkëveprim, vardisje*

Rezultati/et  e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan sjelljet bashkëvepruese të shtazëve.*
*Shpjegon arsyet e sjelljeve shoqërore, territoriale të shtazëve*
*Krahason sjelljet mes shtazëve të ndryshme.*

Kriteret e suksesit:

*Trego shembuj të komunikimit me zë, të komunikimit kimik, të komunikimit me dritë, të vardisjes te shtazët.*
*Jep shemuj të shënimit të territorit te shtazët e ndryshme*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri  Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim,  Gjeografi,*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MENDO, PUNO, THUAJE

*Mësimdhënësi/ja krijon grupe dhe jepen tema të kundërta, njërit grup për një shoqëri shtazësh, ndërsa grupit tjetër për një shoqëri shpezësh dhe dy grupet i lexojnë shoqëritë e gjallesave.*

GJEJE TITULLIN

*Lexohet teksti pa titull nga nxënësit dhe jepen mendime si mund të titullohet mësimi, pastaj mësimdhënësi/ja merr përgjigjen e saktë nga nxënësit. Punohet: lexohet individualisht për sjellje shoqërore, territoriale, komunikimi dhe vardisje, bashkëpunohet në dyshe dhe në grup.*

SHKRIM I LIRË

*Kërkojmë nga nxënësit të shkruajnë për "Sjelljet e shtazëve që jetojnë në bashkësi", 5- 10 minuta, pastaj disa nga shkrimet lexohen dhe diskutohen për to. Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletoren e punës.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Të hulumtojnë nxënësit në internet video të zonave nga Safari (Afrikë), ku jetojnë në grupe-llavë luanët, hienat etj., kopetë e zebrave, buajve etj. Në bazë të asaj që kanë parë shënojnë në fletore, pastaj diskutojnë në orën e ardhshme të biologjisë.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Hulumton konkurrencën e ndërsjellë të organizmave për plotësimin e nevojave themelore jetësore (bimëve për dritë, hapësirë, ujë dhe lëndë minerale nga toka, kurse shtazët për hapësirë, ushqim dhe partnerin për riprodhim) Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella brenda species (p.sh. ujqit udhëtojnë në grup për të mbrojtur territorin e tyre, rrisin të vegjëlit (këlyshët) e tyre dhe gjuajnë prenë e madhe).* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**II- 6.** *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.*

**III- 5.** *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

**IV 7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Struktura trupore përcaktuese e sjelljes së shtazëve**

Fjalët kyçe: *Grabitqar, perceptim, pre*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan karakteristikat strukturale trupore të maces si grabitqare dhe të lepurit si pre-viktimë.*
*Shpjegon sjelljen e maces si grabitqare në raport me viktimën bazuar në strukturën trupore të saj.*
*- Shpjegon sjelljen e lepurit si viktimë në raport me grabitqarin bazuar në strukturën trupore të tij.*

Kriteret e suksesit:

*Krahaso strukturën trupore dhe sjelljet mes grabitqarit dhe viktimës dhe anasjelltas.*
*Veço çfarë e bënë të veçantë një grabitqarë dhe qfarë e bënë të veçantë një viktimë.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi,*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

STUHI MENDIMESH

*U jepet nxënësve në tabelë tema "Struktura trupore, përcaktuese e sjelljeve te shtazët". Nxiten ata për të shkruar të gjitha mendimet që kanë në fletët e tyre. Më pas arsimtari shkruan në tabelë të gjitha idetë e nxënësve.*

*Pranohen të gjitha idetë e nxënësve, edhe nëse nuk janë shumë të qarta ose shumë të sakta. Nxiten nxënësit të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri-tjetrit.*

SISTEMI NDËRVEPRUES I SHËNIMEVE (INSERT)

*Nxënësit do të lexojnë tekstin e do të vendosin në anë të tij shenjat. Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit për përdorimin e shenjave: v - pohon se ajo që lexuan nxënësit, është e njohur prej tyre,(shtazë grabitqare) + - një pjesë e informacionit është i ri për nxënësit (strukturë trupore),- nëse informacioni që lexojnë kundërshton ose është i ndryshëm nga ajo që dinë ose mendonin se dinin, ? - informacion i paqartë ose ka diçka më shumë që duhet të dinë rreth këtij informacioni. Pasi mbaron leximi i tekstit dhe nxënësit vendosin shenjat, mësimdhënësi/ja drejton pyetjet: Cilat njohuri që i kishit më parë janë pohuar në tekst? Çfarë informacioni të ri nxorët gjatë leximit? Cilat janë pyetjet që keni? Pas diskutimit të përgjigjeve të pyetjeve, nxënësit do të punojnë dyshe për të renditur informacionin në tabelë. V + - ? Mësimdhënësi/ja bën përmbledhjen e nformacionit në tabelë, pasi nxënësit kanë bërë komentet e diskutimet e tyre. Ndalet në shpjegimin e atij informacioni, për të cilin nxënësit kanë nevojë.*

IMAGJINATË E DREJTUAR

*Mësimdhënësi/ja u parashtron nxënësve një situatë të tillë. Kërkojmë një vullnetar të vijë dhe të shënojë në një shtyllë shtazët grabitqare dhe në një tjetër shtazët viktimë. Kërkojmë nga nxënësit e tjerë në klasë që të përmendin lloje që ata dinë nga grabitqarët dhe viktimat.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

I *udhëzojmë nxënësit që përmes internetit të gjejnë video, ku bëhet lufta mes grabitqarit dhe shtazëve viktimë.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Përshkruan marrëdhëniet e ndërsjella ndërmjet specieve të ndryshme duke mos përdorur emërtime shkencore për këto marrëdhënie vetëm duke pasur parasysh dobinë ose dëmin nga bashkëjetesa e tyre dhe shpjegojnë se si këto marrëdhënie mbështesin qëndrueshmërinë e biodiversitetit.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I **2.** *Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve.*

III- **5.** *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike.*

III **6.** *Përdor programet softuerike adekuate për zgjidhjen e problemeve dhe kryerjen e detyrave/punimeve shkollore dhe joshkollore në fusha të ndryshme të dijes.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Sjelljet ciklike**

Fjalët kyçe: *Cikël, mjedis i jashtëm, ritme stinore, ritme biologjike, fototropizëm, gjeotropizëm*.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*Përshkruan sjelljet ciklike të shtazëve dhe faktorët që ndikojnë në këto sjellje.*
*Shpjegon sjelljet e bimëve dhe shtazëve si përgjigje ndaj ndryshimit të mjedisit të jashtëm.*
*Shpjegon efektin e ndërrimit ditë-natë dhe të stinëve në mbajtjen e ritmeve biologjike stinore te shtazët.*

Kriteret e suksesit:

*Përcakto dhe shpjego llojet e ritmeve stinore.*
*Shpjego mënyrat e lëvizjes së organeve bimore në përgjigje të burimit të ngacmimit.*
*Krahaso fototropizmin dhe gjeotropizmin.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi,*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

SHKRIM I SHPEJTË

*Mësimdhënësi/ja nxit nxënësit të shkruajnë për disa shpendë që ikin në vjeshtë dhe kthehen në pranverë, pastaj i lexojmë disa prej tyre*

HULUMTIM I PËRBASHKËT

*U kërkohet nxënësve të hapin librat dhe mësimdhënësi/ja ka përgatitur skeda me pyetje apo kërkesa që do t'i ndihmojnë nxënësit të kuptojnë tekstin. Nxënësi A: 1. Çfarë e shtyn lëvizjen e lejlekut dhe të dallëndyshes që të vijnë në pranverë dhe të shkojnë në vjeshtë? 2.A keni dëgjuar se ariu dhe disa shtazë të tjera bien në gjumë dimëror? Nxënësi B: 1. Çka kuptoni me lëvizje nastike? Kështu vazhdojmë edhe me pyetje të tjera. Pasi jepen pyetjet dhe i tregohet secilit grup ku do të përqendrohen, bashkohen në grupe të gjithë nxënësit me shkronjën A. E kështu me radhë. Nxënësit e njërit grup diskutojnë rreth materialit të tyre dhe bëhen ekspertë. Më pas këta ekspertë kthehen në grupin fillestar, ku japin mësim për atë çka mësuan. Më pas mësimdhënësi zhvillon një diskutim, duke përmbledhur informacionin që japin nxënësit. (Sipas mundësive në klasë shfrytëzohet laptopi dhe interneti për gjetje të infomacioneve shtesë apo edhe kërkesave të parashtruara)*

MBAJTJA E STRUKTURUAR E SHËNIMEVE,

*Nxënësit janë të ndarë në grupe me 4-5 nxënës dhe zhvillojnë veprimtarinë e përshkruar në libër. Nxënësit vëzhgojnë dhe mbajnë shënime në grup. Mësimdhënësi/ja ndjek nga afër punën e grupeve dhe përmbledh në dërrasë përgjigjet e tyre. Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletoren e punës.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*I Nxënësve u kërkohet të hulumtojnë në internet për sjellje instinktive, të lindura dhe të trashëguara te shtazët.*

| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
|---|
| |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Shfrytëzon organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme. Përdorë fjalor të duhur shkencor dhe teknologjik gjatë komunikimit gojor ose me shkrim duke përfshirë: klasifikimi, biodiversiteti, bashkësia jetësore natyrore (biocenoza), marrëdhëniet e ndërsjella, vertebrorët- kurrizorët, invertebrorët-parruazorët, stabiliteti, karakteristikat, organizmi etj.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I4.** *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit ..*

**II -7.** *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.*

**III- 3.** *Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Organizimi i biocenozave dhe qëndrueshmëria e ekosistemeve**

Fjalët kyçe: *Katëzim mbitokësor, nëntokësor, biocenozë, dinamikë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*-Dallon organizimin e biocenozave në hapësirë dhe kohë.*
*- Shpjegon organizimin hapësinor të biocenozave përmes mënyrës së katëzimit.*
*- Shpjegon organizimin kohor të biocenozave përmes aspekteve që ndryshojnë gjatë periudhave të ndryshme të vitit.*

Kriteret e suksesit:

*Krahaso katëzimin mbitokësor dhe atë nëntokësor.*
*Numëro faktorët që ndikojnë në organizimin e biocenozave*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi,*

| PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE |
|---|
| DISKUTIM PËR NJOHURITË PARAPRAKE<br><br>*Shënohet në tabelë (ose në fletë të madhe të bardhë) shprehja katëzim. Lihen nxënësit për tre minuta të renditin në fletët e tyre fjalët që lidhen me këtë term. Më pas pyeten nxënësit për fjalët, lidhjet a marrëdhëniet rreth termit dhe shkruhen ato në tabelë ose në fletë. Aktivizohen të gjithë nxënësit. Kur secili të ketë ofruar një lidhje, u kërkohet të japin ide të mëtejshme. Renditen në tabelë mendimet e tyre (pa i komentuar ato). Nxiten të pyesin rreth temave për t'i qartësuar ato dhe për të zgjeruar të kuptuarit e tyre. (Që në fillim të etapës u kujtohet nxënësve të respektojnë njëri-tjetrin gjatë diskutimit).*<br><br>LEXIM I DREJTUAR<br><br>*Lexohet titulli Organizimi i biocenozave (paragrafi i parë). Nxënësit japin parashikimin e tyre për përmbajtjen e paragrafit. Pastaj lexohet paragrafi dhe bëhet krahasimi i informacionit me atë që parashikuan ata. Në këtë moment mësimdhënësi/ja sqaron koncepte a pyetje që mund t'u lindin nxënësve. Kështu vazhdohet dhe me paragrafët e tjerë me nëntitujt: Cilët janë faktorët që ndikojnë në organizimin e biocenozave barishtore? Sa lloje katëzimesh kemi? Përcakto faktorët që ndikojnë në organizimin kohor të biocenozave.*<br><br>SHKRIM I LIRË,<br><br>*Shkrim i lirë me temën "Renditja e llojeve në kate". Nxënësit punojnë të pavarur për disa minuta. Bëhet vlerësimi i disa nxënësve, duke pasur parasysh dhe punën e bërë në fazat e tjera. Udhëzohen nxënësit të plotësojnë fletoren e punës.* |
| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
| *Vlerësimi me gojë  (diskutime, debate, prezantime).* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Seleksiononi disa fotografi,të shkarkuara nga interneti apo nese keni mundësi bëni fotografi të ndonjë pylli ku mund t'i vëreni katëzimet..*<br>*Hulumtoni për suksesionet* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës    Lënda: Biologji    Shkalla e kurrikulës: III    Klasa:VI | |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Shfrytëzon organizues grafik për të treguar krahasimet mes organizmave në biocenoza të ndryshme.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**II** -**7.** *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.*

**III** **1.** *Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon*

**IV-** **7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Suksesionet (njëpasnjëshmë ritë) ekologjike**

Fjalët kyçe: *Suksesion parësor dhe dytësor, abiotik, biotik*.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*-Përshkruan suksesionet ekologjike.*
*- Dallon suksesionin parësor dhe atë dytësor.*
*- Përcakton faktorët që ndikojnë në suksesionet ekologjike*.

Kriteret e suksesit:

*Krahaso suksesionin parësor dhe atë dytësor.*
*Trego karakteristikat e suksesionit parësor dhe atij dytësor*
*Sqaro si ndikon njeriu në rritjen e suksesioneve*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, detyrat e shtëpisë*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi,*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

PËRMBLEDHJE E STRUKTURUAR

*Mësimdhënësi/ja prezanton temën dhe mjetet që do të përdoren, duke ngjitur në tabelë: foto, pamje të ndryshme të suksesioneve në liqen. Pastaj, pasi nxënësit i vëzhgojnë ato, mësimdhënësi/ja paraqet shkurt pikat kryesore të mësimit, duke i shkruar në tabelë ose letër të madhe. Ndryshimet që ndodhin me kalimin e kohës, në përbërjen dhe strukturën e llojeve të një biocenoze quhen suksesione (njëpasnjëshmëri) ekologjike. Kemi dy lloje suksesionesh.*

## LEXIM/PËRMBLEDHJE NË DYSHE

*Mësimdhënësi/ja u thotë nxënësve të krijojnë dyshe (me nxënësin në krah), ku njëri do të lexojë paragrafin me zë dhe pastaj do të bëjë një përmbledhje (shkurt, por të përmbajë idetë kryesore të paragrafit). U lihet koha e nevojshme, pastaj kontrollohet përvetësimi, duke dëgjuar përmbledhjet e disa nxënësve. Mund të bëhen sugjerime, po qe e nevojshme. Pas kësaj nxënësi tjetër bën pyetje për pjesën (paragrafin). U lihet koha e mjaftueshme për ta bërë këtë dhe përsëri kontrolloni sa e kanë kuptuar, duke dëgjuar pyetje prej disa nxënësve. Përsëri mund të bëni sugjerime për përmirësim, kur është rasti. Përsëritet procedura, si dhe shfrytëzohen të gjeturat e nxënësve nga detyrat e shtëpisë.*

## DIAGRAMI I VENIT,

*Nxënësit me grupe, të drejtuar nga mësimdhënësi/ja, bëjnë Diagrame të Venit për të paraqitur të përbashkëtat dhe ndryshimet ndërmjet suksesioneve. P.sh., Grupi I – Suksesioni parësor paraqitet në ato biotope, ku më parë nuk ka ekzistuar bota e gjallë. Grupi II – Suksesioni dytësor ndodh në vendet ku më parë ka ekzistuar biocenoza, e cila është shkatërruar nga ndonjë faktor i mjedisit të jashtëm. (Pastaj i shkruajmë të përbashkëtat). Pasi përfundojnë, përfaqësuesit e grupeve i paraqesin para klasës. Bëhet vlerësimi i grupit për saktësinë e plotësimit të detyrës, shpejtësinë dhe paraqitjen e saj*




| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| *Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime), Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.* |

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
|---|
| *Hulumtoni suksesionet në deponinë e hirit në Kastriot gjatë disa dekadave.* |

| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
|---|
| |

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):

**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):

*Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale.*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I-6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

IV- 7. *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla, varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Klasifikimi i ekosistemeve**

Fjalët kyçe: *Ekosistemet ujore dhe tokësore, delta, batica, zbatica, antropogjenë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*-Jep një pasqyrë të biomave ujore.*
*-Shpjegon ekosistemet që përbëjnë biomën e ujërave të ëmbla dhe atë që përbëjnë biomën e ujërave të njelmëta,*
*- Përshkruan rreziqet e biomave ujore nga aktivitetet e ndryshme të njerëzve.*

Kriteret e suksesit:

*- Emërto biomat ujore,*
*- Dallo ekosistemet që e përbëjnë biomën e ujërave të ëmbla dhe biomën e ujërave të njelmëta.*
*-Identifiko faktorët që ndikojnë në dallimin e biomës së ujërave të ëmbla dhe të njelmëta.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi,*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

STUHI MENDIMESH

*Shkruhet në tabelë tema "Klasifikimi i ekosistemeve". Nxënësit japin mendime rreth saj, duke sjellë edhe shembuj nga ekosistemet ujore dhe tokësore. Mësimdhënësi/ja i shënon në tabelë, pa bërë komente për to. Në fund nxjerr një përfundim (pohim) rreth ekosistemeve ujore, tokësore, të cilin e shkruan në tabelë.*

LEXIM/PËRMBLEDHJE NË DYSHE

*Në orët e mëparshme e kemi shpjeguar si funksionon kjo metodë. Mësimdhënësi/ja e ndan klasën në grupe me nga pesë nxënës. Secili anëtar është përgjegjës për të lexuar një pjesë. Mësimdhënësi/ja ka përgatitur për çdo nxënës fletën e ekspertit me 2- 3 pyetje, të cilat i ndihmojnë të përmbledhin më mirë tekstin e lexuar. Kështu mësimi ndahet në pesë çështje. Ekosisteme ujore: Për nxënësit e grupit A mësimdhënësi/ja ka përgatitur pyetjet: Nxënësi A - Çfarë tregon për ndotjen e ujërave? Eksperti A - Pse ujërat duhet të jenë të pastër? Ekosistemet tokësore: Nxënësi B – Si ndahen ekosistemet tokësore? Eksperti B - Çfarë sjellin temperaturat shumë të larta apo shumë të ulëta për bimët? Ekosisteme detare dhe oqeanike: Nxënësi C – Sa për qind përfshijnë ekosistemet tokësore të biosferës? Eksperti C Ekosisteme tokësore natyrore: Nxënësi Ç Ekosisteme tokësore natyrore-antropogjene: Nxënësi D Eksperti D Nxënësit lexojnë në mënyrë të pavarur pjesët e përzgjedhura. Mësimdhënësi/ja i rigrupon nxënësit sipas shkronjës që kanë. Ata diskutojnë dhe krahasojnë përgjigjet e tyre, shënimet, kërkojnë shpjegime në mënyrë që të kthehen në ekspertë për pjesën e tyre. Mësimdhënësi/ja zhvillon një diskutim me tërë klasën, duke bërë kështu organizimin e informacionit.*

## ORGANIZUESI GRAFIK I ANALOGJISË

*Për të krijuar një lidhje analogjie me konceptin e ri "Përqindja e ekosistemeve" mund të zgjidhet si koncept i njohur nga mësimdhënësi/ja koncepti "ujëra". Paraqitet organizuesi grafik i analogjisë në tabelë. Zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth karaktereve të përbashkëta e të veçanta për të dy konceptet. Paraqesin at përkatësisht në kolonën e ngjashmërive dhe ndryshimeve. Shkruhen të përmbledhura ngjashmëritë e dallimet e dy koncepteve në tabelë nga mësimdhënësi/ja. Nxënësit udhëzohen të plotësojnë fletoren e punës.*

### VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime), Vlerësimi i detyrave të shtëpisë.*

### DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Të zhvillojnë eksperimentin për të provuar efektet e dëmshme të derdhjes së naftës në ujë (sipas përshkrimit në fletoren e punës).*

### REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI |

| | |
|---|---|
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I**-6. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

**III** 1. *Kërkon dhe përzgjedh të dhëna nga burime të ndryshme (si: libra, revista, doracakë, fjalorë, enciklopedi ose internet), të cilat i shfrytëzon për realizimin e temës/detyrës së dhënë dhe i klasifikon ato burime sipas rëndësisë që kanë për temën.*

**IV**- 7. *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Biomet tokësore**

Fjalët kyçe: *Tundra, pyje tropikale, pyje halore*.

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

-*Përshkruan biomat tokësore.*

- *Shpjegon biomat pyjore halore dhe gjetherënëse*.

-*Definon konceptin stelë*

Kriteret e suksesit:

- *Identifiko kushtet jetësore në tajgë*
- *Emërto vendet ku janë të përhapura pyjet gjetherënëse.*
- *Përshkruaj rëndësinë e stelës*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi,*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

STUHI MENDIMESH

*Shkruhet në tabelë temën "Biomet tokësore". Nxënësit japin mendime rreth saj, duke sjellë edhe shembuj nga informacionet që kanë deri tani për biomet në fjalë. Mësimdhënësi/ja i shënon në tabelë, pa bërë komente për to. Në fund nxjerr një përfundim (pohim) rreth ekosistemeve tokësore, të cilin e shkruan në tabelë*.

SHTROJA E TAVOLINËS

*Fillimishtë nxënësit hapin librin dhe lexojnë për pak minuta njësinë mësimore nga libri. Ndërkohë mësimdhënësi-ja përgatit një letër të madhe me pjesë individuale dhe pjesë të përbashkët në mes (sikur në paraqitjen vizuale) për të arritur rezultate.! Hapi 1: Nxënësit i shkruajnë idetë në pjesë individualisht pa folur me askënd (caktojeni kohën, sa minuta) Hapi 2: Nxënësit ecin përreth në drejtim të akrepave të orës (ose në drejtim të kundërt me akrepat e orës) dhe lexojnë çfarë kanë shkruar në ato pjesë. Hapi 3: Nxënësit i diskutojnë idetë e tyre dhe i shkruajnë rezultatet më relevante në mes, (tri deri në pesë aspekte) Hapi 4: Një nxënës ja prezanton rezultatet tërë grupit ose një çiftit tjetër. Nxënësit e tjerë i ndihmojnë nëse ka nevojë..*



DISKUTIM

*Pasi nxënësit kanë punuar shtrojën e tavolinës ata tani janë në fazën e diskutimit, pasi mbarojnë punën brenda grupeve, fillojnë diskutimin në rreth më të gjerë. Fillimisht prezanton grupi i parë punimin e tyre dhe atë çfarë kanë shkruar në mes të tavolinës e vendosin në tabelë, kështu veprohet me të gjitha grupet. Pastaj ftohet një nxënës që të bëjë përmbledhjen e të gjitha koncepteve të paraqitura në tabelë.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI |
|---|---|---|---|

| Tema ( nga– plani dymujor): **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): *Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale.* |
|---|---|

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I-3**. *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio, TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

**III 5.** *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike*

**IV- 7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Pyjet e zonave me klimë të nxehtë**

Fjalët kyçe: *Pyje gjethetrasha, klima mesdhetare, subtropikale..*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Identifikon llojet bimore dhe shtazore karakteristike të pyjeve gjethetrasha dhe atyre tropikale të shiut.*
-*Përshkruan rëndësinë e pyjeve gjethetrasha dhe atyre tropikale të shiut*
-*Numëron bimët e dobishme mjekësore dhe ushqyese*

Kriteret e suksesit:

- *Dallo karakteristikat e pyjeve gjethetrasha dhe atyre tropikale të shiut*
- *Identifiko vlerat ekologjike të këtyre pyjeve*
- *Emërto të paktën 3 bimë mjeksore dhe ushqyese*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, fletë A4*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe Mjedisi*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

MENDONI

*Fillimisht shkruhet në tabelë titulli i mësimit "***Pyjet e zonave me klimë të nxehtë"** *dhe u kërkohet nxënësve të mendojnë dhe të shkruajnë në fleta të bardha atë çfarë kanë menduar për temën e dhënë, pra të shpalosin njohuritë e tyre se çfarë dinë për pyjet e zonave me klimë të nxehtë . Në këtë fazë kërkohet vetëm të mendojnë, mos të flasin një me tjetrin.*

PUNONI NË ÇIFT

*Pasi nxënësit kanë rikujtuar njohuritë e tyre, ata tani punojnë në çiftë, shpalosin njohuritë te partneri i bankës. Pastaj u kërkohet që të lexojnë njësinë mësimore në heshtje, dhe duke shfrytëzuar shënimet praprake të markojnë në libër njohuritë e reja. Dhe po të njejtat ti shkruajnë si informata të reja në fletën që shfrytëzuan më parë.*

NDAJENI

*Pasi nxënësit kanë lexur njësinë mësimore nga libri dhe kanë markuar njohuritë e reja që morën pas leximit, tani ata përsëri diskutojnë- ndajnë njohuritë e fituara me partnerin e bankës. Mësimdhënësi/ja mund të mbledhë fletat e punuara dhe në mënyrë rastësore do të zgjedh disa nxënës për diskutim.*

| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| *Vlerësimi me gojë  (diskutime, debate, prezantime).* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Të hulumtojnë në internet për pyjet tropikale, për llojet e bimëve dhe shtazëve që janë të pranishme.* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës  Lënda: Biologji  Shkalla e kurrikulës: III  Klasa:VI | |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Rezultati  i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale. Tregon të kuptuarit se habitatet e ndryshme mbështesin bashkësitë e ndryshme jetësore (kopshti, livadhi, pema, këneta, përroi etj.).* |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.<br>**III-3**. *Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohe*<br>**III 5.** *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjike*<br>**IV- 7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klase/shkolle apo jashtë saj.* | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :<br>*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*<br>*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.* | |
| ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
| Njësia mësimore: **Biomet barishtore** | |
| Fjalët kyçe: *Bioma, stepa, savane, kullota.* | |
| Rezultati/et  e të nxënit për orë mësimore:<br>- *Përshkruan biomat barishtore.*<br>-*Sqaro dallimet e botës bimore e shtazore në mes të stepave e savaneve*<br>- *Shpjegon shkaqet e zvogëlimit të biomave barishtore*<br><br>Kriteret e suksesit:<br>- *Identifiko nga fotografia biomet barishtore*<br>-*Emërto disa lloje bimore e shtazore karakteristike për këto biome*<br>-*Numëro disa shkaqe që qojnë në zvogëlimin e biomeve barishtore* | |
| Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:<br><br>*Libri  Biologjia 6,* | |

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

GRUPI GUMËZHITËS

*Shkruhet në tabelë titulli i njësisë mësimore, dhe mësimdhënësi-ja u kërkon nxënësve të shkëmbejnë idet e tyre sa më shpejt, ide të cilat mund të shfrytëzohen më vonë në diskutime ose në ndonjë formë tjetër të punës. Nxënësit gumëzhisin për temën e dhënë njëri me tjetrin ( flasin me zë të ulët duke gumëzhitur si bletët) bisedojnë për gjërat për të cilat janë duke menduar. Pas kësaj u kërkohet të shpalosin mendimet e tyre edhe për klasën (ose grup më të gjerë).*

LEXIM - PËRMBLEDHJE NË DYSHE. PUNË NË GRUPE,

*Mësimdhënësi/ja hap librin dhe u tregon nxënësve tekstin që do të punojnë në dyshe. Ndahet teksti në paragraf, në mënyrë që ata ta kenë më të lehtë përpunimin e tekstit. Kjo procedurë është shpjeguar dhe një herë, por po e rikujtojmë. Njëri nga nxënësit lexon paragrafin dhe e përmbledh, ndërsa tjetri bën pyetje rreth materialit të përmbledhur. Në qoftë se shohim që paragrafi është përvetësuar, në paragrafin tjetër nxënësit ndërrojnë rolet. Mësimdhënësi/ja i ndjek nga afër punën e dysheve. Rëndësi u kushton përgjigjeve për pyetjet: Ku shtrihen biomat barishtore? Në cilat stinë të vitit zhvillohen stepat e në të cilat savanet?*

KLLASTER

*Mësimdhënësi/ja i lë nxënësit për 5 minuta të shkruajnë se çfarë mësuan për biomat, ndarjen e biomave, në formë përmbledhje përmes kllasterit. Më pas u kërkon nxënësve të njejtin kllaster ta punojnë edhe në tabelë, këtu do të jenë pjesëmarrës grup më i madh i nxënësve dhe kllaster do të ketë më shumë informacione, pasi jo të gjithë shkruajnë fjalët-informatat e njejta në fletoret e tyre.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Të hulumtojnë gjitarët që jetojnë në stepa dhe savane.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I**-3. *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio ,TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*

**II** 6. *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim*

**IV-** 7. *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*
*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Biomet me kushte të papërshtatshme**

Fjalët kyçe: *Biome, tundër, shkretëtirë, deve, ari polar, ujk polar*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Përshkruan karakteristikat e tundrave*
- *Përshkruan karakteristikat e shkretëtirave*
- *Shpjegon si mbijetojnë organizmat në tundër dhe shkretëtira*.

Kriteret e suksesit:

- *Trego karakteristikat e botës bimore e shtazore që jetojnë në tundër dhe shkretëtirë*
- *Sqaro si janë përshtatur jetës llojet shtazore në këto biome*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, llaoptop, projektor, fotografi nga interneti*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, TIK*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAXHINATË E DREJTUAR

*Mësimdhënësi/ja shfaq në ekran disa fotografi dhe u kërkon nxënësve të mendojnë se cili është mesazhi që duan të tregojnë përmes këtyre fotografive, apo edhe çfarë mendojnë ata spo të shohin fotografitë. (nëse nuk ka mundësi të shafqen në projektor, laptop, apo tv mund edhe të printohen dhe të shpërndahen fotografitë e tilla).*





 

# LEXIM - PËRMBLEDHJE NË DYSHE. PUNË NË GRUPE,

*Nxënësit do të punojnë në dyshe. Nxënësi I do të lexojë me zë pjesën e pare të mësimit ‘’TUNDRA” deri te titulli i pjesës së dytë. Të dy nxënësit bashkë do të shkruajnë në anë të paragrafit termat kryesorë të tij. Nxënësi II bën pyetje për tekstin, duke përdorur termat anash. Ai I shkruan këto pyetje në fletë të vogla. Nxënësi I përgjigjet dhe, nëse të dy janë dakord me përgjigjen, e shkruajnë atë në pjesën e pasme të fletës. - Pasi nxënësit të kenë mbaruar leximin, termat, pyetjet e përgjigjet e pjesës së parë, mësimdhënësi i rishikon dhe sugjeron, korrigjon aty ku është e nevojshme. - Për paragrafët e tjerë nxënësit shkëmbejnë rolet. Gjatë rishikimit të paragrafëve me mësimdhënësin/en, nxënësit do të krahasojnë përgjigjet e pyetjeve me rezultatet e provave.*

# KLLASTER

*Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që njohuritë e fituara ti paraqesin në formë të diagramit të venit. Pra në njërën anë të shkruajnë të veçantat e tundrave, kurse në anën tjetër të shkruajnë të veçantat e shkretëtirave, kurse në mes të shkruajnë karakteristika e përbashkëta për këto dy lloje.*




| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| *Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime),* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Të hulumtojnë në internet për shtrirjen e tundrës, dhe shkretëtirave* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Krahason dhe bënë dallimin mes eksosistemeve natyrore dhe artificiale.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**II-1**. *Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.*

**II 7.** *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.*

**III- 3.** *Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Ekosistemet tokësore të kultivuara – antropogjene**

Fjalët kyçe: *Agroekosistem, kultivim, antropogjene, agrobiocenozë.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*-Përshkruan ekosistemet tokësore të kultivuara.*
*- Dallon ekosistemet e kultivuara të tipit pyjor dhe bujqësor.*
*- Krahason ekosistemet e kultivuara dhe ato natyrore.*

Kriteret e suksesit:

*-Sqaro se në zona të ndryshme të kontinenteve ka agroekosisteme të ndryshme.*
*- Emërto përbërësit e një agroekosistemi.*
*- Identifiko veçoritë e ekosistemeve natyrore nga ato të kultivuara*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Fizikë, TIK, Edukatë qytetare*

**PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE**

STUHI MENDIMESH

*U kërkohet nxënësve të mendojnë rreth drithërave që kultivohen në vendin tonë. Mësimdhënësi/ja drejton pyetjen: Ç' është agroekosistemi? Lihen nxënësit të lirë të thonë atë çka mendojnë, pa ndërhyrë apo komentuar.*

LEXIM - PËRMBLEDHJE NË DYSHE. PUNË NË GRUPE,

*Nxënësit do të punojnë në dyshe. Ndahet teksti në paragrafë. Nxënësi i parë do të lexojë paragrafin e parë (ekosistemet antropogjene) me zë dhe do të bëjë përmbledhjen e tij. Kërkohet nga disa nxënës të thonë përmbledhjen e paragrafit. Nëse është e nevojshme, jepen sugjerime nga mësimdhënësi/ja. Nxënësi i dytë bën pyetje rreth këtij paragrafi. Disa nxënës thonë pyetjet e tyre. Bëhen sugjerime për t'i përmirësuar ato. Nxënësi i parë jep përgjigjet e pyetjeve. Disa nxënës thonë përgjigjet e tyre e mësimdhënësi/ja ose shokët mund t'i plotësojnë e saktësojnë ato. Vazhdohet kështu me çdo paragraf, duke këmbyer idetë e tyre. Mësimdhënësi/ja kujdeset të jepen përgjigje për pyetjet: Ekosistemet ndahet në dy tipa: cilët janë ata? Si quhen pyjet që menaxhohen nga njeriu? Pse një pyll, në të cilin njerëzit mbjellin vetëm bredhin, apo një sipërfaqe ku mbjellin vetëm hardhinë a ullirin, quhen monokulturë? Përgjigjet i shkruajmë në tabelë.*

KLLASTER

*Paraqitet tema në tabelë me anë të një kllasteri. Nxiten nxënësit të thonë të gjitha mendimet që lidhen me mbjelljen e monokulturave. Mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë, duke u kujdesur që nxënësit të mos kritikojnë idetë e njëri-tjetrit. I nxisim ata të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri-tjetrit dhe i shkruan ato në tabelë.*




| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
|---|
| *Vlerësimi me gojë (diskutime, debate, prezantime).* |

| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
|---|
| *Hulumtojnë në internet: - Kultivimi i monokulturës në vendit tonë si monokultura e bredhit, hardhisë së rrushit, ullirit.* |

| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
|---|
| |

**Periudha e III**

**Prill-Maj-Qershor**

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | ***Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: p.sh. Ruajtja-konservim i biodiverstetit, pyllëzimi; Ndikimi negativ: p.sh. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.***<br>• *Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

I-2. *Dëgjon në mënyrë aktive pyetjet dhe komentet e bëra nga të tjerët për temën e prezantuar të fushës së caktuar, duke u paraqitur nëpërmjet pyetjeve, komenteve, sqarimeve dhe propozimeve*

II 6. *Interpreton rregullat e zhvillimit të një procesi natyror apo shoqëror, duke e ilustruar atë me shembuj konkretë, si: ilustrim, skicë ose me shkrim.*

III- 3. *Zbaton në mënyrë të pavarur udhëzimet e dhëna në libër ose në një burim tjetër për të nxënë një temë, veprim, aktivitet ose detyrë që i kërkohet*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Ndikimi i njeriut në natyrë dhe në mjedis jetësor**

Fjalët kyçe: *fenomen, mjedis jetësor, biodiversitet, energji.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Përshkruan ndikimet e njeriut në natyrë dhe mjedis jetësor.*
- *Sqaron burimet e ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme.*
- *Krahason ndikimin e fenomeneve natyrore dhe atyre njerëzore në natyrë dhe mjedis jetësor.*

Kriteret e suksesit:

*-Dallo ndikimet negative të njeriut në natyrë dhe mjedis jetësor*
- *Krahaso burimet e ripërtëritshme dhe jo të ripërtëritshme.*
- *Identifiko pasojat e civilizimit për mjedisin jetësor.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Fizikë, Edukatë qytetare*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

" DI"

*Në fazën e parë të mësimit ata plotësojnë kolonën "DI" me njohuritë që kanë rreth ndikimit të njeriut në mjedisin jetësor. Njohuri këto të fituara edhe më parë nga temat e periudhës së parë, më sakt njësia mësimore biodeiversiteti. Mësimdhënësi/ja paraqet edhe në tabelë kolonat, pastaj fton disa nxënës të lexojnë disa nga informacionet që ata kanë për temën, dhe kështu i shkruan në tabelë*

" DUA TË DI"

*Në kolonën dua të di nxënësit shkruajnë pyetje se çfarë duan të dinë për ndikimet e njeriut në mjedisin jetësor, nëse për këtë pjesë nuk kanë pyetje, atëherë mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në libër dhe nëse aty gjejnë diqka të paqartë e shkruajnë si pyetje ose çfarë duan të dinë më shumë.*

"MËSOVA"

*Ndërsa kolonën Mësova- e plotësojnë me njohuritë e reja të fituara. Kështu veprohet edhe në tabelën e punuar për të gjithë klasën, mësimdhënësi/ja fton disa nxënës të shkruajnë edhe në tabelë njohuritë e tyre të fituara.*

| *DI* | *DUA TË DI* | *MËSOVA* |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Projekt- si duhet të ngritet vetëdija ekologjike e qytetarëve?*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | ***Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ) . Ndikimi pozitiv: p.sh.Ruajtja-konservim i biodiverstetit, pyllëzimi; Ndikimi negative: p.sh. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi , ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.***<br>• *Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi , ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**II**-**7.** *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.*

**IV** **3**. *Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.*

**IV-** **7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore:Cilët janë **faktorët e shkatërrimit të pyjeve**

Fjalët kyçe: *Dëmtim, strese natyrore, shiu acid*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Përshkruan shkaktarët e dëmtimit të pyjeve*
- *Shpjegon pasojat e shfaqura në pyje nga dëmtimet e ndryshme*
- *Sqaron efektin e shiut acidik në shkatërrimin e drurëve dhe organizmave të tjerë, si dhe dëmtimin e ndërtesave dhe monumenteve të ndryshme.*

Kriteret e suksesit:

-. *Identifiko shkaktarët e dëmtimit të pyjeve*
- *Dallo ndikimin e shiut acid te drurët, dëmtimin e ndërtesave dhe monumenteve*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Fizikë, Edukatë qytetare*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

DISKUTIM PËR NJOHURITË PARAPRAKE

*U sugjerohet nxënësve për diskutim koncepti "dëmtimet e pyjeve", duke e shkruar atë në dërrasën e zezë, kurse nxënësit në fletë. U lihen tre minuta kohë të mendojnë e të renditin në letër, lidhje apo marrëdhënie rreth termit. Më pas pyetën nxënësit për këto, duke filluar me nxënësit më pak aktivë, për të rritur përfshirjen e tyre dhe të gjithëve në diskutim. Renditen mendimet e nxënësve pa komente. Nxiten nxënësit të pyesin rreth shprehjeve të renditur me qëllim që të qartësohen apo përpunohen shprehjet. Gjatë pyetjeve e përgjigjeve të shpejta nxënësit bisedojnë me njëri-tjetrin dhe zbulojnë temën.*

DRTA

*Lexohet titulli "CILËT JANË FAKTORËT E SHKATËRRIMIT TË PYJEVE - EKOSISTEMEVE MË PRODUKTIVE DHE MË TË RËNDËSISHME NË NATYRË?" dhe nxënësit japin parashikimin për pjesën që vjen. Pastaj lexohet paragrafi dhe bëhet krahasimi me parashikimin. Kështu vazhdohet dhe për paragrafët e tjerë deri në fund.*

## KLLASTER

*Paraqitet tema në tabelë me anë të një kllasteri. Nxiten nxënësit të thonë të gjitha mendimet që lidhen me faktorët shkatrrues të eskosistemeve pyjore, në mënyrë që të ketë sa më shumë mendime dhe bashkëpunim në mes të nxënësve, punojnë kllasterin në grupe. Mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë, duke u kujdesur që nxënësit të mos kritikojnë idetë e njëri-tjetrit. I nxisim ata të ndërtojnë argumente mbi idetë e njëri-tjetrit.*




VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informata kthyese, vlerësim i ndersjelltë)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Nxënësit i udhëzojmë që në mënyrë individuale të hulumtojnë lidhur me shkaktarët e shkatërrimit të pyjeve.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

**ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

| Tema ( nga– plani dymujor): | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor): |
|---|---|
| **Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | *Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: p.sh.Ruajtja-konservim i biodiverstetit, pyllëzimi; Ndikimi negative: p.sh.* ***Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.***<br>• ***Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.*** *Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I**-**6**. *Shpjegon qartë dhe saktë, me gojë ose me shkrim, kuptimin e termave (fjalëve, koncepteve) të reja, duke përdorur gjuhën dhe fjalorin adekuat dhe të saktë.*

**II**-**7.** *Krahason ngjashmëritë dhe dallimet e fazave më të rëndësishme nëpër të cilat është zhvilluar një proces/dukuri shoqërore, natyrore ose artistike.*

**III** **5**. *Ndërlidh temën e dhënë, që është duke e mësuar, me njohuritë dhe përvojat paraprake që tashmë i ka, duke i paraqitur ato në forma të ndryshme të të shprehurit (kolona, tabela, grafikë) sipas një radhitjeje logjik.*

**IV** **1.** *Përgatit planin për organizimin e një aktiviteti të caktuar në shkollë ose në komunitet dhe e realizon atë me sukses.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

**ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE**

Njësia mësimore: **Ndotja e mjedisit dhe masat për mbrojtjen e tij**

Fjalët kyçe: *Pesticide, plehra, ambalazhe, industri, ndotje*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Përshkruan ndotësit më të shpeshtë të ajrit, tokës dhe të ujit.*
- *Identifikon pasojat nga ndotja e ajrit, ujit dhe tokës.*
- *Identifikon sëmundjet që mund të shkaktohen te ne nga ndotja e ajrit, ujit, tokës dhe shpjegon masat që duhet të merren për mbrojtje nga ndotja.*

Kriteret e suksesit:

-. *Numëro ndotësit kryesorë të ajrit, ujit dhe tokës.*
- *Vlerëso rëndësinë e ujit, ajrit dhe tokës*
-*Identifiko disa mënyra se si duhet të mbrojmë nga ndotja ajrin, ujin ,dhe tokën*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Fizikë, TIK, Edukatë qytetare*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAXHINATË E DREJTUAR

*Mësimdhënësi/ja shfaq në ekran disa fotografi dhe u kërkon nxënësve të mendojnë se cili është mesazhi që duan të tregojnë përmes këtyre fotografive, apo edhe çfarë mendojnë ata spo të shohin fotografitë. (nëse nuk ka mundësi të shafqen në projektor, llaptop, apo tv mund edhe të printohen dhe të shpërndahen fotografitë e tilla).*







DRTA

*Mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit që të lexojnë njësinë mësimore fillimisht vetëm paragrafin e parë, dhe të diskutojnë se për çfarë u bë fjalë, kështu vazhdohet edhe me paragrafët tjerë deri sa të mbaroj njësia mësimore.*

DISKUTIM

*Kërkohet nga nxënësit që të mbyllin librat dhe të fillojnë diskutimin për njësinë mësimore. Fillimisht u jepet fjala atyre nxënësve të cilët janë më pasiv, duke u munduar që sado pak të marrin pjesë në mësimnxënie aktive. Nëse ka nevojë mësimdhënësi/ja e drejton diskutimin përmes pyetjve si këto:*

*Numëroni ndotësit më të shpeshtë të ajrit, ujit dhe tokës?*

*Analizoni pasojat e ajit, ujit dhe tokës së ndotur?*

*Identifikoni masat që duhet të merren për mbrojtjen e ajrit, ujit dhe tokës?..etj..*

*Ndërkohë nxënësit përgadisin një plan për një aktivitet që ka të bëjë me vetëdisimin e popullatës lidhur me ndotjen e ajrit, ujit dhe tokës.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë).*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Hulumtim në literaturë dhe internet për ndotësit kryesorë në vendit tonë, si: ndotësit e ujit, tokës, ajrit.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

**PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE**

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës Lënda: Biologji Shkalla e kurrikulës: III Klasa:VI | |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Qeniet e gjalla dhe mjedisi jetësor** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Jep shembuj të ndikimit të njeriut në mjedis (pozitiv dhe negativ). Ndikimi pozitiv: p.sh.Ruajtja-konservim i biodiverstetit, pyllëzimi; Ndikimi negative: p.sh. Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.*<br><br>*• Hulumton dhe shpjegon shkaqet dhe pasojat e ndotjes së ajrit, ujit dhe tokës në mjedisin e drejtpërdrejtë të tij.* ***Zvogëlimi i resurseve natyrore, shpyllëzimi, ndotja (tokë/ujë/ajër), ngrohja globale.*** |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**II**- **1.** *Paraqet argumente për pajtueshmëri ose kundërshtim të një qëndrimi ose mendimi për një temë/ problem të caktuar gjatë një debati ose të publikuar në medie.*

**IV** **3**. *Diskuton në grup moshatarësh për rëndësinë që ka mbrojtja e mjedisit, për pasojat që sjell dëmtimi i mjedisit për jetën e njeriut dhe propozon masat që duhet të ndërmerren për evitimin e tyre.*

**IV-** **7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Ndryshimi i klimës – Ngrohja globale**

Fjalët kyçe: *Gazra, klor, flor, serrë, ozon, dioksid karboni (CO2).*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

*-Identifikon shkaktarët e efektit serrë .*
*- Përshkruan pasojat e ngrohjes globale.*
*- Identifikon mënyrat dhe mundësitë e reduktimit të dioksidit të karbonit, si shkaktar themelor i ngrohjes globale.*

Kriteret e suksesit:

*-Sqaro rolin e njeriut për ngrohjen globale*
*- Trego rëndësinë e mbështjellësit të ozonit për botën e gjallë.*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, fletë pune-shtroja e tavolinës*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Gjeografi, Ekologjia dhe mjedisi, Fizikë, Edukatë qytetare*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

## STUHI MENDIMESH

*Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titulin e mësimit dhe u kërkon nxënësve fillimishtë të mendojnë për njohuritë e tyre lidhur me temën e dhënë. Pastaj fton disa nga ta të diskutojnë dhe të shpalosin mendimet e tyre për Ngrohjen Globale, duke mos i pohuar apo mohuar mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë në mënyrë që vetë nxënësit të vetëvlerësojnë mendimet e tyre pasi të kenë mësuar njësinë mësimore.*

## SHTROJA E TAVOLINËS

*Përgatiteni një letër të madhe me pjesë individuale dhe pjesë të përbashkët në mes (sikur në paraqitjen vizuale) për të arritur rezultate. Pasi keni shpalosur temën në tabelë dhe nxënësit të kenë lexuar njësinë mësimore nga libri ftoni ata të punojnë shtrojën e tavolinës (fletata nëse ka mundësi i siguron mësimdhënësi, nëse jo ato mund të punohen edhe nga vetë nxënësit.) Hapi 1: Nxënësit i shkruajnë idetë në pjesë individualisht pa folur me askënd (caktojeni kohën, sa minuta) Hapi 2: Nxënësit ecin përreth në drejtim të akrepave të orës (ose në drejtim të kundërt me akrepat e orës) dhe lexojnë çfarë kanë shkruar në ato pjesë. Hapi 3: Nxënësit i diskutojnë idetë e tyre dhe i shkruajnë rezultatet më relevante në mes, (tri deri në pesë aspekte).*




## DISKUTIM

*Kërkohet nga nxënësit që të mbyllin librat dhe të fillojnë diskutimin për njësinë mësimore, duke shfrytëzuar vetëm fletat e punës. Të gjitha grupet kanë mundësi të prezantojnë mendimet e tyre, prezantimin e bënë përfaqësuesi i grupit dhe të tjerët e ndihmojnë atë nëse ka nevojë. Dhe krejt në fund nxënësit mund të bëjnë vlerësimin e mendimeve (ideve) të tyre lidhur me ngrohjen globale, mendime këto të shprehura në fillim të orës mësimore.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë).*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Nxënësve u kërkohet të hulumtojnë në internet apo ndonjë material tjetër (si enciklopedi etj.) rreth shkaktarëve të ndotjes, rritjes së sasisë së reshjeve.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | | | |
|---|---|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI |

| | |
|---|---|
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Vlerëson rëndësinë e higjienës personale për shëndetin e tyre.* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I** - **4**. *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit ..*

**IV** **4.** *Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet..*

**IV-** **7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet e mjedisit, qëndrueshmërinë e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Si ta mbajmë higjienën për një jetë të shëndetshme**

Fjalët kyçe: *Higjienë, zona rurale dhe urbane, kurimi.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Shpjegon rëndësinë e higjienës personale.*
- *Përshkruan mbajtjen e higjienës brenda shtëpisë.*
- *Vlerëson gjendjes e higjienës së klasës dhe ndikimin e saj në shëndet*

Kriteret e suksesit:

- *Sqaro rëndësinë e higjienës së trupit*
- *Trego mënyrat më të mira që qojnë në një trup të pastërt të dhe shëndetshëm.*
- *Përshkruaj pastërtin e klasës duke identifikuar rolin e ndotësve në shëndetin tuaj*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6, llaptop, projektor, fotografi nga interneti*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Art figurativ, TIK, Edukatë qytetare*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

IMAXHINATË E DREJTUAR

*Mësimdhënësi/ja shfaq në ekran disa fotografi dhe u kërkon nxënësve të mendojnë se cili është mesazhi që duan të tregojnë përmes këtyre fotografive, apo edhe çfarë mendojnë ata spo të shohin fotografitë. (nëse nuk ka mundësi të shafqen në projektor, llaptop, apo tv mund edhe të printohen dhe të shpërndahen fotografitë e tilla). Pastaj nxënësit shprehin mendimet e tyre lidhur me atë se çfarë po shohin.*







NDËRTIMI I NJOHURIVE DRTA OSE LEXIM I DREJTUAR

*Nxënësit lexojnë titullin dhe japin mendime e parashikime për përmbajtjen e paragrafit të parë, (higjiena personale, urbane dhe rurale), duke i argumentuar ato. Pasi lexojnë paragrafin e parë, ata krahasojnë përmbajtjen e tij me parashikimin e tyre. Vazhdohet kështu me gjithë tekstin. Mësimdhënësi/ja kujdeset për të sqaruar konceptet kryesore gjatë leximit me ndalesa. Diskutohet rreth  informacionit të marrë në tekst dhe informacioneve të sjella nga vetë nxënësit.*

SHKRIM I SHPEJTË

*Në minutat e fundit të orës nxënësit do të shkruajnë shumë shkurt dhe shumë shpejt në lidhje me temën "Higjiena në komuniteti". Në këtë shkrim nxënësit do të përmbledhin mendimet në lidhje me temën dhe informacionin që morën. Disa nxënës lexojnë shkrimet e tyre. Mësimdhënësi/ja do të përqendrohet në idetë e hedhura në letër, e jo në paraqitjen e shkrimit. (Mënyrën si po e  shkruajnë: me gabime apo me shkrim të parregullt). Jepet një fjali e pambaruar si temë.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësimi me gojë  (diskutime, debate, prezantime)*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Hulumtim, si mbahet higjiena në vendin tonë.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

# PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës     Lënda: Biologji     Shkalla e kurrikulës: III     Klasa:VI | |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Shpjegon procesin e rritjes dhe zhvillimit, proceseve riprodhuese njerëzore dhe problemet e abuzimit seksual..* |

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**I** - **4**. *Shpreh mendimin/gjykimin për një temë të caktuar ose prezantim artistik, me anë të të folurit ose me shkrim si dhe në forma të tjera të komunikimit ..*

**IV 4.** *Identifikon dhe vlerëson burimet e nevojshme (p.sh., pajisjet, materialet, burimet njerëzore, kohën etj.) për realizimin e një aktiviteti në shkollë ose në komunitet..*

**IV- 7.** *Bashkëvepron në mënyrë aktive me moshatarët dhe të tjerët (pavarësisht statusit të tyre social, etnik etj.) për realizimin e një aktiviteti të përbashkët (projekti/aktiviteti në bazë klasë/shkollë apo jashtë saj.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

## ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Riprodhimi te njeriu dhe edukata seksuale**

Fjalët kyçe: *Higjienë, zona rurale dhe urbane, kurimi.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Definon termin dimorfizëm seksual*
- *Përshkruan ndryshimet fizike trupore te meshkujt dhe femrat.*
-*Shpjegon procesin e riprodhimit njerëzor*

Kriteret e suksesit:

-*Identifiko ndryshimet te meshkujt dhe femrat gjatë pubertetit*
-*Sqaro rëndësinë e riprodhimit*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Art figurativ, Edukatë qytetare*

## PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

" DI"

*Në fazën e parë të mësimit nxënësit plotësojnë kolonën "DI" me njohuritë që kanë rreth riprodhimit të njeriut dhe edukatës seksuale. Mësimdhënësi/ja paraqet edhe në tabelë kolonat, pastaj fton disa nxënës të lexojnë disa nga informacionet që ata kanë për temën, dhe kështu i shkruan në tabelë.*

" DUA TË DI"

*Në kolonën dua të di nxënësit shkruajnë pyetje se çfarë duan të dinë për riprodhimin dhe edukatën seksuale, nëse për këtë pjesë nuk kanë pyetje, atëherë mësimdhënësi/ja i udhëzon nxënësit të lexojnë njësinë mësimore në libër dhe nëse aty gjejnë diqka të paqartë e shkruajnë si pyetje ose çfarë duan të dinë më shumë.*

"MËSOVA"

*Ndërsa kolonën Mësova- e plotësojnë me njohuritë e reja të fituara. Kështu veprohet edhe në tabelën e punuar për të gjithë klasën, mësimdhënësi/ja fton disa nxënës të shkruajnë edhe në tabelë njohuritë e tyre të fituara.*

| *DI* | *DUA TË DI* | *MËSOVA* |
|---|---|---|
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |
| | | |

VLERËSIMI I NXËNËSVE

*Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë.*

DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR

*Nxënësit i udhëzojmë që në mënyrë individuale të hulumtojnë për pubertetin.*

REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës | Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III | Klasa:VI

Tema ( nga– plani dymujor):

**Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut**

Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):

*Shpjegon ndryshimet biologjike të pubertetit*

Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.

**V** 3.*Diskuton në grup moshatarësh, duke ofruar argumente, për rëndësinë që ka respektimi i regjimit ditor dhe i aktiviteteve fizike për shëndetin dhe për jetën e njeriut.*

**V-** 9. *Përshkruan ndryshimet fizike, psikike dhe emocionale të fazës së pubertetit duke paraqitur fakte për ndikimin e tyre në mënyrën (stilin) e jetesës.*

**VI** 6. *Dëshmon vetëbesim të lartë në marrjen e vendimeve për veprimet që ndërmerr, pa i dëmtuar interesat e të tjerëve, të cilat kontribuojnë në rritjen cilësisë e së aktivitetit të grupit shoqëror apo të komunitetit.*

Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) :

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*

*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Puberteti**

Fjalët kyçe: *Pubertet, adoleshent, cikli menstrual, spermë, epididim.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Identifikon strukturat riprodhuese të meshkujve dhe femrave dhe funksionet e tyre.*
- *Përshkruan fazat e ciklit menstrual.*
- *Shpjegon kujdesin për higjienën e trupit gjatë pubertetit.*

Kriteret e suksesit:

-*Identifiko strukturat riprodhuese te dy gjinitë.*
- *Sqaro si duhet të jetë përkujdesi për trupin gjatë pubertetit*

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

"STUHI MENDIMESH"

*Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titulin e mësimit dhe u kërkon nxënësve fillimishtë të mendojnë për njohuritë e tyre lidhur me temën e dhënë. Pastaj fton disa nga ta të diskutojnë dhe të shpalosin mendimet e tyre për pubertetin, duke mos i pohuar apo mohuar mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë në mënyrë që vetë nxënësit të vetëvlerësojnë mendimet e tyre pasi të kenë mësuar njësinë mësimore.*

LEXIM I DREJTUAR

*Lexohet titulli "Cilat janë ndryshimet e tjera në pubertet" (paragrafi i parë). Nxënësit japin parashikimin e tyre për përmbajtjen e paragrafit. Pastaj lexohet paragrafi dhe bëhet krahasimi i informacionit me atë që parashikuan ata. Në këtë moment mësimdhënësi/ja sqaron koncepte a pyetje që mund t'u lindin nxënësve. Kështu vazhdohet dhe me paragrafët e tjerë me nëntitujt: Ndryshimet që ndodhin te meshkujt dhe femrat.*

DIAGRAMI I VENIT

*Mësimdhënësi/ja u kërkon nxënësve që njohuritë e fituara ti paraqesin në formë të diagramit të venit. Pra në njërën anë të shkruajnë të ndryshimet karakteristike që shfaqen te gjinia mashkullore, kurse në anën tjetër të shkruajnë karakteristikat që shfaqen te gjinia femrore gjatë pubertetit kurse në mes të shkruajnë karakteristika e përbashkëta për të dyja gjinitë.*




| |
|---|
| VLERËSIMI I NXËNËSVE |
| *Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë.* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Hulumtojnë nxënësit; - Ndryshimet te mashkulli, si zëri, mollëza e Adamit. - Ndërsa te femrat, cikli menstrual.* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

## PLANIFIKIMI I ORËS MËSIMORE

| ASPEKTET E PËRGJITHSHME TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE | |
|---|---|
| Fusha kurrikulare: Shkencat e natyrës    Lënda: Biologji | Shkalla e kurrikulës: III    Klasa:VI |
| Tema ( nga– plani dymujor):<br><br>**Shëndeti, sjelljet dhe emocionet e njeriut** | Rezultati i të nxënit të temës ( nga plani dymujor):<br>*Analizon dhe diskuton zhvillimin seksual gjate cikleve të ndryshme të jetës.*<br>• *Identifikon institucionet ku mund të kërkojë ndihmë adekuat.* |
| Rezultatet e të nxënit për kompetencat kryesore të shkallës (të synuara):.<br>**I** 3. *Veçon porosinë kryesore të lexuar ose të dëgjuar nga një burim, si libër, gazetë, revistë, internet, radio TV etj., e komenton dhe e shfrytëzon atë si referencë gjatë hartimit të një punimi/detyre me shkrim.*<br>**III-** **8.** *Menaxhon emocionet dhe ndjenjat, kohën, shfrytëzimin e materialeve, mjetet që ka gjatë kryerjes së një detyre/aktiviteti, vepre arti (në klasë/shkollë apo gjetiu).*<br>**V** 7. *Kërkon ndihmë/këshillë pa hezitim nga personat dhe shërbimet përkatëse për përkrahje a mbështetje në situata të supozuara si potencialisht të rrezikshme në të cilat cenohet shëndeti fizik dhe mendo.*<br>**VI** 7. *Identifikon paragjykimet që mund të ekzistojnë në shkollë dhe në rrethinë si dhe propozon veprime konkrete për luftimin e tyre.* | |
| Rezultatet e fushës së kurrikulës (të synuara) : | |

*Përshkruan dhe sqaron rritjen dhe mbijetesën e qenieve të gjalla varësisht nga kushtet të mjedisit, qëndrueshmërin e ekosistemeve, ndërtimin dhe funksionin e sistemeve kryesore të organeve të njeriut, strukturat dhe proceset e involvuara në rritjen dhe riprodhimin e bimëve, shtazëve dhe njeriut.*
*Përshkruan ndikimin e të ushqyerit, ushtrimeve fizike, barnave dhe drogave në sjelljet, shëndetin dhe procesin jetësorë të njeriut.*

ASPEKTET SPECIFIKE TË PLANIT TË ORËS MËSIMORE

Njësia mësimore: **Seksualiteti njerzor**

Fjalët kyçe: *Heteroseksualiteti, homoseksualiteti, biseksualiteti.*

Rezultati/et e të nxënit për orë mësimore:

- *Identifikon llojet e seksualitetit te njerëzit.*
- *Përshkruan karakteristikat e individëve me përkatësi të ndryshme të seksualitetit.*
- *Identifikon dhe përshkruan abuzimet seksuale*

Kriteret e suksesit:

- *Trego llojet e seksualitetit dhe përshkruaj individët me përkatësi të ndryshme të seksualitetit.*
- *Sqaro termin abuzim seksual*.

Burimet, mjetet e konkretizimit dhe materialet mësimore:

*Libri Biologjia 6,*

Lidhja me lëndët tjera mësimore dhe/apo me çështjet ndërkurrikulare dhe situata jetësore:

*Gjuhë dhe komunikim, Edukatë qytetare*

PËRSHKRIMI I METODOLOGJISË DHE VEPRIMTARITË E PUNËS ME NXËNËS GJATË ORËS MËSIMORE

“STUHI MENDIMESH”

*Mësimdhënësi/ja shkruan në tabelë titullin e mësimit dhe u kërkon nxënësve fillimishtë të mendojnë për njohuritë e tyre lidhur me temën e dhënë. Pastaj fton disa nga ta të diskutojnë dhe të shpalosin mendimet e tyre për seksualitetin njerëzor, duke mos i pohuar apo mohuar mendimet e tyre mësimdhënësi/ja i shkruan ato në tabelë në mënyrë që vetë nxënësit të vetëvlerësojnë mendimet e tyre pasi të kenë mësuar njësinë mësimore.*

INSERT

*Hapet libri dhe lexohet mësimi, duke vendosur shenjat e teknikës INSERT. Ato janë: një “☑” për ato që lexojnë dhe i dinë; një “-“ për ato informacione që janë të ndryshme nga ato që dinë; një “+” për informacionin e ri për ta; një “?” për informacionin e paqartë ose duhet të dijë më shumë;*

| ☑ | + | - | ? |
|---|---|---|---|
| | | | |
| | | | |
| | | | |

RRJETI I DISKUTIMIT

*Për të krijuar një lidhje analogjie me konceptin e ri “seksualiteti njerëzor”, mund të zgjidhet si koncept i njohur nga mësimdhënësi/ja koncepti “abuzime seksuale”. Paraqitet organizuesi grafik i analogjisë në tabelë. Zhvillohet një diskutim me nxënësit rreth karaktereve të përbashkëta e të veçanta për të dy konceptet. Paraqiten ato përkatësisht në kolonën e ngjashmërive dhe ndryshimeve. Shkruhen të përmbledhura ngjashmëritë e dallimet e dy koncepteve në tabelë nga mësimdhënësi/ja.*

VLERËSIMI I NXËNËSVE

| |
|---|
| *Vlerësim për nxënie ( informate kthyese, vlerësim i ndersjelltë.* |
| DETYRAT DHE PUNA E PAVARUR |
| *Të hulumtojnë në internet për abuzimet e ndryshme seksuale.* |
| REFLEKTIM PËR RRJEDHËN EORËS MËSIMORE |
| |

## TEST VLERËSUES

***Rretho përgjigjen e saktë***

1. **Trego kush i studion marrëdhëniet e caktuara në mes të organizmave dhe kushteve të mjedisit të jashtëm, si dhe marrëdhëniet në mes të vetë organizmave?**
   a) Botanika
   b) Etologjia
   c) Zoologjia
   d) Ekologjia

2. **Si quhen ndikimet që vijnë nga bota jo e gjallë në atë të gjallë?**
   a) ndikimet abiotike
   b) ndikimet biotike
   c) ndikimet antropologjike
   d) ndikimet historike

3. **Prej sa përbërësve ndërtohet një ekosistem?**
   a) një përbërësi
   b) dy përbërësve
   c) tre përbërësve
   d) katër përbërësve

4. **Në aspektin ekologjik, çka paraqet një lum?**
   a) botop
   b) biocenozë

c) biom
d) ekosistem

**5. Cila nga hallkat e zingjirit ushqimor e përbënë nivelin e dytë trofik (ushqimor)?**
a) prodhuesit
b) konsumuesit
c) zbërthyesit
d) furnizuesit

**6. Trego kush e paraqet tërësinë e individëve të një lloji, në një vendbanim (habitat) të caktuar!**
a) migrimi
b) imigrimi
c) popullata
d) lindshmëria

**7. Çfarë ndërveprimi është simbioza?**
a) i dëmshëm
b) i dobishëm
c) neutral
d) jo i dëmshëm, jopërfitues

**8. Në një ekosistem me kalimin e kohës ndodhin ndryshime në përbërjen dhe strukturën e llojeve të tij. Si quhen ato ndryshime?**
a) organizime hapësinore
b) organizime kohore
c) suksesione
d) biocenoza

**9. Cilën kategori të shënuar në vijim e formojnë disa ekosisteme të ngjashme?**

a) biotopin

b) biomin

c) biociklin

d) biosferën

**10. Cilat janë ekosistemet më të rëndësishme dhe më produktive në natyrë?**

a) lumenjtë

b) liqenet

c) livadhet

d) pyjet

**Vlerësimi**

| Pikët | 0 – 39 | 40 – 59 | 60 – 79 | 80 - 89 | 90 - 100 |
|---|---|---|---|---|---|
| Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |

## STEST VLERËSUES

***Rretho, shkruaj përgjigjen e saktë.***

1. **Trego si rezultat i mungesëssë kujt në ushqime shkaktohet anemia!**
   a) karbohidrateve
   b) yndyrave
   c) vitaminës C
   d) hekurit

2. **Nga mungesa e cilave ushqime shkaktoht kapsllëku?**
   a) karbohidrateve
   b) yndyrave
   c) vitaminave
   d) fibrave

3. **Çka rekomandohet të hamë sa më pak?**
   a) pemë
   b) perime
   c) ushqime të përpunuara
   d) drithëra

4. **Sa herë brenda ditës rekomandohet që t'i pastrojmë dhëmbët?**
   a) një herë
   b) dy herë
   c) tri herë
   d) katër herë

**5. Në mes të individit mashkull dhe femër të të njëjtit lloj ekziston ndryshueshmëria për nga forma dhe ndërtimi. Si quhet kjo ndryshueshmëri?**

a) pubertet
b) dimorfizëm seksual
c) seksualitet
**d)** adoleshencë

**6. Në fazën e pubertetit adoleshentët duhet të ken kujdes çfarë ushqimi hanë. Trego se ushqimet që ata hanë duhet të përmbajnë sa më pak:**

a) proteina
b) yndyra
c) vitamina
d) kripëra minerale

**7. Çfarë seksualiteti është kur një djalë bie në dashuri me një vajzë ose në vajzë me një djalë?**

a) biseksualitet
b) heteroseksualitet
c) homoseksualitet
d) asnjërën

**8. Si quhet përdorimi i kërcënimit ose fuqisë për të detyruar marrëdhënie seksuale ose veprime të tjera?**

a) pedofili
b) racizëm
c) incest
d) përdhunim

**8. Cila drogë në vijim është e ligjshme?**

a) kokaina,

b) duhani

c) kanabisi

d) asnjëra

**10. Shkruaj dy sëmundjet të shkaktuara nga pirja e duhanit!**______________________________________________________

_____________________________________________________________

**Vlerësimi**

| Pikët | 0 – 39 | 40 – 59 | 60 - 79 | 80 - 89 | 90 - 100 |
|---|---|---|---|---|---|
| Nota | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |